



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Shkenca Kompjuterike të Aplikuara”
“Universiteti ‘Aleksandër Moisiu’, Durrës ”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Assoc.Dr. Ana Ktona

Dr. Alketa Grepcka

Mars 2020

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 10, datë 07.04.2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara” (më tej MPSHKA) është hapur me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 43, Datë 04/02/2013, dhe fillimisht ka qënë me 90 kredite (1.5 vite akademike). Së fundmi programi është riorganizuar me vendim të MASR Nr.7242/1 Prot, datë 31.08.2018 për të qënë në përputhje me ndryshimet ligjore [VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018] dhe sot është me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 1 (një) vit akademik.

GVJ ka konstatuar që tashmë IAL “Aleksander Moisiu” zotëron të gjithë kuadrin ligjor dhe strukturat drejtuese dhe mbështetëse për të garantuar një mirëfunksionim të programit të studimit.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 48 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 20 janë me grada dhe tituj. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) i cili është përgjegjës për MPSHKA përbëhet nga 18 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 3 zotërojnë gradën ‘Doktor Shkencash’, 4 janë në vazhdim të studimeve doktorale, ndërsa pjesa tjetër kanë kualifikimin Master shkencor. Gjatë vitit akademik 2017-2018, vit kur është bërë dhe riorganizimi, në këtë program janë aktivizuar 4 pedagogë si personel akademik me kontratë të gjithë me tituj dhe grada. Gjatë vitit akademik 2018-2019 janë aktivizuar në këtë program 3 PAK dhe 7 PAE të gjithë me tituj dhe grada. Në vitin akademik 2019-2020 aktivizohen në program 8 PAE.

GVJ konstaton Programi MPSHKA është organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 1 vit dhe në total 60 kredite.

GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë MPSHKA, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara synon specializimin e studentëve në planifikimin, projektimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web profesionale, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike, krijimin, menaxhimin dhe administrimin e bazave të të dhënave;

GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë të studimit MPSHKA përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018 - Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL. Secila prej lëndëve ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite ku çdo lëndë ka 6 kredite. Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese në leksione, seminare, dhe laboratore/praktikë.

GVJ konstaton se programi përmban 5 lëndë të detyrueshme + 2 grup-lëndë me zgjedhje (ku secila prej grup-lëndëve ka tre lëndë nga të cilat studenti zgjedh një prej tyre) + Praktikën + Provimin Përfundimtar. Ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator/praktikë) paraqitet qartë.

GVJ konstaton se dosja e plotë të programit të studimit MPSHKA përmban informacionet për ngarkesën mesimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.

Përgjegjësi i Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike angazhon koordinatoret e programeve të studimit të mbledhin syllabuset e përditësuara me tema dhe literatura të reja bashkëkohore për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike. Këto përmirësime nuk i kalojnë 20% të ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Gjatë vizitës në institucion, intervista me stafin akademik, u

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

theksua se çdo semester stafi mblidhet për të diskutuar në lidhje me syllabuset dhe ndryshimet që mund të bëhen në të. GVJ konstaton se syllabuset e dorëzuara sipas formatit të ri mbajnë datën Tetor 2018.

GVJ konstaton se raportet midis formimit teorik dhe praktik janë të përshtatshme për arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike, krijimin, menaxhimin dhe administrimin e bazave të të dhënave.

GVJ konstaton se programi i studimit MPSHKA ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli master.

Programi i studimit MPSHKA u jep mundësi studentëve të pozicionohen më së miri në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhër Nr.84, datë 16.10.2019 të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, aplikuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë MPSHKA.

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit MPSHKA, kanë realizuar vizitat në datat 22 dhe 25 Nëntor 2019, në Institucionin e Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë MPSHKA, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Zgjatja e periudhës së hartimit të këtij raporti u bë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit (në të cilin UAMD pati pasoja). Me datë 4 dhjetor UAMD dërgon nëpërmjet sistemit vendimin e Rektoratit për pezullimin e procesit mësimor për shkak të tërmetit, deri në një vendim të dytë. Kjo solli vonesa në plotësimin e dosjes me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar gjatë vizitës.

Më datë 21.02.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 4/22 Prot., datë 24.02.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UAMD përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 337/1 Prot., datë 24.02.2020 “Mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të Ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Kompjuterike të Aplikuara”. Në këtë dokument institucioni deklaroi se nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Aleksander Moisiu” përmes programe të tij, ku pjesë përbërëse është edhe programi MPShKA ka impakt në zhvillimin e arsimit, shkencës dhe ekonomisë. Institucioni jep kontributin në diversitetin e ideve, konsolidimin e shoqërisë përmes një veprimtarië arsimore dhe educative [DVV dok.2 –neni 4, Statuti i UAMD].
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit MPShKA ndikon në konsolidimin e vlerave akademike kombëtare. Veprimtaria e këtij programi realizohet brenda sistemit arsimor e kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar dhe rezultatet e tij kanë impakt në tregun e punës në Shqipëri [DVV evidence nga dokumentacioni dhe vizita dy dite në Institucion].
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit MPShKA zhvillohet brenda një kuadri ligjor dhe institucional të konsoliduar. Ky program është në përputhje me qëllimin dhe misionin e IAL “Aleksandër Moisiu” i cili në bazën e veprimtarisë së tij ka për qëllim [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar të punës; b) Të formojë shkencëtarë të rinj, nëpërmjet punës kërkimore – shkencore të nivelit më të lartë bashkëkohor; c) Të realizojë kualifikime shkencore të personelit akademik në fushat e shkencave të mirëfillta teorikë e të shkencave të zbatuara; d) Të terheqë specialistët më të mirë, të krijojë kushte, të nxisë dhe inkurajojë rritjen e aftësive akademike dhe të kontributit të tyre ; e) Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qendrueshme, si edhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit; [dok. 2 – neni 4, Statuti i UAMD], <p>Në misionin e tij UAMD synon në:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) krijimin, zhvillimin dhe përcjelljen e dijeve përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor. b) Të formojë specialistë të lartë e të përgatisë shkencëtarë të rinj; c) Të zhvillojë të menduarit kritik e analitik; <p>Programi i studimit Mastër Profesional në “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara” është në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL “Aleksander Moisiu”, cituar më lart, në përputhje me misionin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit [dok. 2 – neni 2, Statuti</p>

	UAMD]; [dok.6 – neni 1, Rregullore e FIT].			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar mbi bazën e një studimi tregu të punës në vend, zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit, shkencave kompjuterike. Formimi profesional që ky program synon të realizojë përmes aftesimit teorik dhe praktik të studentëve ndikon në përmbushjen e vet kërkesave të tregut në vend [dok.14 - Studimi I tregut pas diplomimit];			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit MPSHKA zhvillohet në Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Nga studimi i dokumentacionit dhe takimeve përkatëse evidentohet se ky program ofrohet dhe përmirësohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit. Në strategjinë e UAMD (2016-2020) përmenden 9 dimensionet bazë, ndër të cilat vlen të përmenden dimensionet 5 ku theksi është vënë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ofertë e zgjeruar akademike</i> • <i>Mentorimi, alumni dhe karriera:</i> • <i>Laboratore të kerkimit të aplikuar:</i> • <i>Biblioteka interaktive dhe të personalizuar:</i> • <i>Investime thelbësore në infrastrukturen kulturore, sportive dhe rekreative:</i> <p>Synimet dhe objektivat kryesore reflektohen edhe në Strategjinë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit. Kjo strategji në themel të saj ka Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, hartuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve datë 10.10.2017. Synimet kryesore të theksuara në Strategjinë e TIK i gjen si një zberthim të detajuar të dimensionit 5 në Strategjinë IAL “Aleksander Moisiu”.</p> <p>Në Strategjinë e TIK 2019-2022 janë dhënë edhe veprimet që priten të ndërmerren [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rritet numri i studentëve të suksesshëm • Të rritet numri i të diplomuarve, si edhe të ulët koha e nevojshme për diplomim, duke synuar në periudhën 1-vjecare; • Të sigurohen që studentët e diplomuar në masterin profesional që ofrojnë, të marrin edukimin më të mirë dhe njohuri të shkëlqyera, në mënyrë që të kalojnë me sukses në degë më të larta studimi, ose të punësohen në kompani të vlerësuara


	<p>Në lidhje me prioritet bazë të Strategjisë së TIK (2019-2022) UAMD ka përcaktuar edhe veprimet që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojnë në programin e studimit MPSHKA, si më poshtë:</p> <p><i>Objektivi 1-b Të promovohet diversiteti dhe aksesibiliteti në mënyrë që të sigurohemi që studentët e programit tonë Master Profesional në Shkenca Kompjuterike të Aplikuara të jenë nga vende të ndryshme të Shqipërisë apo diasporës.</i></p> <p><i>Objektivi 2-c Të ofrohen metodika studimi dhe praktika profesionale që ndihmojnë në marrjen e dijeve të nevojshme për të përfunduar në kohë programin e studimit 1-vjecar.</i></p> <p><i>Objektivi 3-a Programi ynë duhet të përshatet në mënyrë që t'u shërbejë interesave të cdo studenti që e zgjedh këtë program studimi, si edhe nevojave të tregut apo ekonomisë shqiptare edhe më gjerë.</i></p> <p><i>Objektivi 3-b Të sigurohet akreditim i vazhdueshëm për programin e studimit.</i></p> <p>[DVV dok. 4- Strategjia e TIK 2019-2022].</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>IAL “Aleksander Moisiu” është një institucion i konsoliduar. Programi i studimit MPSHKA zhvillohet brenda një kuadri të qarte misioni, objektiva dhe prioritete. Ne Statutin e IAL “Aleksander Moisiu”, neni 2 përcakton qarte misionin e institucionit. Ky mision reflektohet në Rregulloren te IAL – UAMD në nenin 3 “Misioni dhe objektivat e Rregullore”. Ne vijim dhe ne përputhshmëri GVJ gjen misionin e Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit në Rregulloren e FIT dhe ne Rregulloren e Programit të Studimit MPSHKA e identifikojmë misionin në nenin 6 të saj. Plotesimi i Misionit dhe objektivat e programit të studimit janë të referuar edhe ne 9 dimensionet bazë të Strategjisë 2016-2020 te IAL UAMD dhe ne 3 prioritet kryesore te Strategjisë së Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit (2019-2022). [DVV dok.6, neni 1- Misioni I Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit],</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p>	<p>Organizimi, përmbajtja e programit të studimit MPSHKA ofrohet në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit, Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Në nenin 7 të Rregullore se TIK, ky master profesional është i projektuar për studentet të cilat janë të diplomuar në ciklin e parë në “Shkenca Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni”, “Sisteme Informacioni”, Bachelor në “Matematikë – Informatikë”, dhe “Informatikë – Anglisht”. Ky program është vijueshmëri e programeve të studimit Bachelor që ofrohen nga Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Ky program është i hartuar për të thelluar më tej studimet dhe për të aftësuar studentët në tregun e punës. [dok. Te dhena tabelore per numrin e programeve qe ofrohen NJB]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të</p>	<p>Programi i studimit MPSHKA është ndërtuar të ofrojë studime të thelluara dhe të aftësojë studentët në fushën e shkencave kompjuterike përmes përthithjes së një kuadri teorik dhe praktik të nevojshëm dhe të kërkuar nga tregu i punës. Programi i studimit zhvillohet mbi bazen e 4 prioriteteve bazë të Strategjisë se Fakultetit të Teknologjisë dhe</p>

zhvillimit.	Informacionit (2019-2022). Kjo strategji është hartuar dhe zbatohet në përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, hartuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve date 10.10.2017 ku janë ofruar edhe prioritet bazë në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit synon në sigurimin që studentët e diplomuar në masterin profesional të marrin edukimin më të mirë dhe njohuri teorike dhe praktike me qëllim punësimin e tyre kompani të vlerësuara. Ky synim është shprehur në Rregulloren e TIK dhe në Strategjinë 2019-2022 për TIK.</p> <p>Nga Rregullorja e programit [cit]:</p> <p>Misioni i Masterit Profesional “Shkenca Kompjuterike te Aplikuara” është që të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. sigurojë një avantazh kryesor, të adaptueshëm dhe relevant në fushën e programimit dhe Informatikës, zbatimin praktik të tyre; 2. krijojë profesionistë të aftë për të lulëzuar në mjedise sfiduese të avancuara 3. njihet me teknikat me të kërkuara, të cilat po zhvillojnë botën teknologjike, 4. ofrojë një program të personalizuar, fleksibël, sfidues dhe një diplomë të dobishme që mbulon bazat bashkëkohore të këtij drejtimi. <p>Programi i studimit është vazhdimësi dhe thellim i njohurive të përfuara në nivelin Bachelor dhe përmes ofrimit të një kuadri teorik dhe praktik tenton në një aftësim më të mirë të studenteve në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe në përshtatshmëri me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit MPSHKA është ndërtuar duke u bazuar në modele programe studimi të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Ky program në themel të tij ka përgatitjen profesionale të studentëve dhe aftësimin sa më të mirë të tyre në tregun e punës. Synimet dhe objektivat e tij janë të shprehur në Strategjinë e Zhvillimit 2019 – 2022 {cit}:</p> <p>Strategjia I: Të rritet numri i studentëve të suksesshëm</p> <p>SYNIMI1: Programi ynë i studimit të bëhet ndër të parat zgjedhje për studentët e interesuar për karrierë në fushën e IT.</p> <p>Objektivil-a Të rrisim cilësinë e studentëve në programet e studimit Bachelor pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.</p>

	<p>Objektivi1-b Të promovohet diversiteti dhe aksesibiliteti në mënyrë që të sigurohemi që studentët e programit tonë Master Profesional në Shkencë Kompjuterike të Aplikuara të jenë nga vende të ndryshme të Shqipërisë apo diasporës;</p> <p>SYNIMI 2: Të rritet numri i të diplomuarve, si edhe të ulet koha e nevojshme për diplomim, duke synuar në periudhën 1-vjecare</p> <p>Objektivi 2-a Të sigurohet suporti i nevojshëm akademik për studentët tanë në mënyrë që të mbarojnë me sukses programin e zgjedhur si edhe të promovohen tek studentët mënyra se si mund t'i përdorin njohuritë e marra si mundësi suksesi për të ardhmen.</p> <p>Objektivi 2-b Të zhvillojmë e të përmirësojmë personelin, pajisjet dhe teknologjitë e duhura për të lehtësuar arritjen e studentëve në majat e suksesit.</p> <p>Objektivi 2-c Të ofrohen metodika studimi dhe praktika profesionale që ndihmojnë në marrjen e dijeve të nevojshme për të përfunduar në kohë programin e studimit 1-vjecar.</p> <p>SYNIMI 3: Të sigurohemi që studentët e diplomuar në masterin profesional që ne ofrojmë, të marrin edukimin më të mirë dhe njohuri të shkëlqyera, në mënyrë që të kalojnë me sukses në degë më të larta studimi, ose të punësohen në kompani të vlerësuara.</p> <p>Objektivi 3-a Programi ynë duhet të përshtatet në mënyrë që t'u shërbejë interesave të çdo studenti që e zgjedh këtë program studimi, si edhe nevojave të tregut apo ekonomisë shqiptare edhe më gjerë.</p> <p>Objektivi 3-b Të sigurohet akreditim i vazhdueshëm për programin e studimit.</p> <p>Objektivi 3-c T'u jepet studentëve mundësia që të paktën një herë gjatë ciklit të studimeve të angazhohen në një aktivitet të nivelit të lartë sic mund të jenë: studime jashtë shtetit, kërkim shkencor, projekte apo internship-e.</p> <p>Këto objektiva janë të zberthyer në aktivitete dhe rezultatet e tyre janë shprehur në raportet vjetore të Njësisë Bazë, në shprehjen e rekomandimeve dhe rrugët për përmirësimin e tyre.</p> <p>Ky program studimi i jep një spekter më të gjerë punësimit të studentëve në fund të studimeve të tyre.</p> <p>Sektorët e punësimit do të jenë kryesisht në fushën e programimit, gjurmimit të dhënave, menaxhim Databazash, studentet do të formohen me kulturën e gjerë aplikative dhe profesionale, në nivel teorik dhe praktik. [Rregullore për Program studimi SHKA]; [Takim me dekanen e FIT, drejtuesen e Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike]. [DVV evidence nr.4 Plani strategjik 2019-2022];</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka ndërmarrë studim tregu në hapjen e këtij program studimi dhe vijon të kryejë sondazhe dhe vrojtime për tendencat dhe zhvillimet e fundit në fushën e shkencave kompjuterike. Në vijim Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka ndërmarrë edhe studim tregu pas diplomimit Në këtë studim janë marrë informacion nga INSTAT në lidhje me zhvillimet në fushën e teknologjisë, si edhe referenca në përmirësimin e programit të studimit nga kompani më të cilat bashkëpunon Departamenti i Shkencave</p>

<p>punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Kompjuterike. [DVV dok. 14.2- Studim tregu pas diplomimit].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MPShKA është hartuar duke marrë edhe modelet e programeve të studimit të ngjashme në universitete të njohura. Synimi në Strategjinë e Zhvillimit (2019-2022) për një rritje të numrit të studenteve përmes përthithjes edhe të studentëve nga diaspora e ka bërë këtë program të jetë në përshtatshmëri me transferimin e studenteve edhe me punësimin e tyre në vend dhe jashtë.</p> <p>Në Rregulloren e FIT neni 39, pika 6, thekson që: Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ofron mundësinë për transferimin e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, në programet e studimit “Master i shkencave” vetëm nëse aplikanti plotëson kriteret pranuese të vitit paraardhës për programin e studimit ku kërkon të transferohet. [dok.nr 6-Rregullore FIT] .</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr. Programet e studimeve në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit organizohen në dy cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë dhe cikli i dytë, referuar niveleve 6-7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit mund të ofrojë edhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. [DVV dok 6-Rregullore e FIT, neni 30, pika 1 dhe 2;]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale. Në kurrikulën e programit të studimit është vendosur edhe praktika profesionale (6 Kredite) dhe konsiderohet e rëndësishme nga studentët. Në takimet e zhvilluara u pranua që praktika profesionale është një domosdoshmëri, por më shumë punë duhet bërë në lidhje me zgjerimin e fushave të bashkëpunimit me kompanitë e biznesit në këtë drejtim. [Dosja e plote e programit të studimit] x</p>
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Studimet në programin MPShKA ofrohen në gjuhën shqipe [DVV neni 18 – Rregullore e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një</p>	<p>Nuk është e aplikueshme</p>




drejtim të caktuar.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ ka konstatuar që tashmë insitucioni zotëron të gjithë kuadrin ligjor dhe strukturat drejtuese dhe mbështetëse për të garantuar një mirëfunksionim të programit të studimit. Programi është ndërtuar mbi bazën e modeleve më të mira në vend dhe jashtë. UAMD zotëron një infrastrukturë të duhur dhe të nevojshme për të garantuar procesin e mësimdhënies. Stafi akademik i angazhuar është pjesë e Departamentit të Shkencave Kompjuterike brenda Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p> <p>Programi MP në Shkenca Kompjuterike të Aplikuara zhvillohet nga një staf i brendshëm dhe i jashtëm me një eksperiencë në fushën e shkencave kompjuterike. Aktualisht për këtë program studimi janë angazhuar:</p> <p>Viti akademik: 2018-2019</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 pedagog me titullin Prof. Dr • 1 pedagog me titullin Prof. Asoc. Dr • 8 pedagogë me gradën shkencore Dr <p>Stafi në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2019-2020 [dok i kërkuar gjatë vizitës Evidenca Nr.24. të dhëna tabelore për stafin akademik në programin e studimit (e plotësuar)] është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 pedagog me titullin Prof. Asoc. Dr • 7 pedagogë me gradën shkencore Dr <p>Bazuar edhe në CV e paraqitura konstatohet se ky staf mbart experiencë në fushën e programit të studimit duke sjellë cilësi në mësimdhënie.</p> <p>UAMD zotëron edhe dy biblioteka të pasura me tekste dhe libra on-line të cilat mundesojnë marrjen e një kuadri teorike të gjerë. Dokumentacioni në lidhje me pasqyrat financiare vërteton një qëndrueshmëri të burimeve financiare dhe potencial të mbështetjes së këtij program për vitet e ardhshme. [33. Te dhena per infrastrukturen UAMD FORMULARI KAPACITETEVE 2018-2019], [34. Lista e librave fizike që ndodhen në bibliotekën 1 për FTI], [35. Udhezues per perdorimin e struktures TI-manuaL AULA], [35.1 kontrata e Sistemi AULA], [36. Te dhena nga fq zyrtare - Calls published in the official website of Aleksandër Moisiu Durrës], [37. raporti monitorimit financiar 12 mujor shtator 2018- gusht 2019 per Bordin], [38. tabela per kostot e programeve MPSHKA], [39. Plani i marketingut te MPSHKA]</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje</p>	<p>Programi i studimit Mastër Profesional në Shkenca Kompjuterike të Aplikuara zhvillohet në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit i cili</p>

<p>me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>përbehet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Matematikës 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit 3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike <p>Në këtë fakultet zhvillohen:</p> <p><u>6 (gjashtë) programe Bachelor:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shkenca Kompjuterike ○ Sistemet e Informacionit ○ Teknologji Informacioni ○ Informatikë-Anglisht ○ Matematikë – Informatikë ○ Multimedia & TV Dixhital <p><u>2 (dy) programe studimi Msc:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shkenca Kompjuterike të Aplikuara, ○ Matematikë- Informatikë <p><u>3 (tre) programe studimi MP:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shkenca Kompjuterike të Aplikuara, ○ Multimedia dhe Televizion Dixhital, ○ Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes. <p>GVJ konstaton se fusha e studimit është në përputhje me fushën akademike të Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike.</p> <p>Kodifikimi i programit të studimit është bërë në nivel insitucional [DVV evidence nr.25 – Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit; evidence nr.6 –Rregullore e NJKTI]</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk është e aplikueshme</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit,</p>	<p>GVJ konstaton një set rregulloresh dhe dokumenta thelbësore mbi bazën e të cilave UAMD funksionon. GVJ ka shqyrtuar me vemendje Statutin e UAMD-së, Rregullore të UAMD-së, Rregullore të FTI, Rregullore të Programit të Studimit të cilat përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturës bazë, të Njësisë Kryesore të Shkencave Kompjuterike si edhe</p>

<p>marrjes së përgjegjësiave respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>rolet dhe përgjegjësitë e stafit akademik dhe studentëve. Në Statut janë të përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave ndihmëse, të cilat më të detajuara i gjejmë në rregulloret përkatëse të tyre. Psh: Rregullorja e SBC, Rregullorja për Sekretarinë Mesimore, Rregullorja e Zyrës së Komunikimit Karrierës & Alumni, Rregullorja e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Rregullorja e Bibliotekës etj. [DVV evidence nr. 2, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 44 dhe 119]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD ka krijuar edhe Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashë dhe Projekteve e cila mundëson nënshkrimin e shumë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja dhe të vendit në kuader të projekteve kërkimore – shkencore, shkëmbimit të stafit akademik. Zyra e Karrierës & Alumni në Rregulloren e saj ka të përcaktuar qarë edhe detyrën për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanië e biznesit në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale dhe punësimit të studenëve.</p> <p>Për të angazhuar edhe pedagogë me kohë të pjesshme janë bërë edhe marrëveshje bashkëpunimi me universitete brenda vendit si Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës etj. [DVV evidence 43 Marrëveshje Përgjegjës/ Lektor; Evidenca nr. 27 – Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe për praktikën profesionale; evidencë nr. 42 – Marrëveshje për mobilitet Erasmus – Agreement 2014-2022 dhe 2015-2021 for mobility of learners and staff; evidence nr. 28 – Raporti Analitik i përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit;]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale janë nënshkruar marrëveshje insitucionale me kompanitë e biznesit. Ndonëse në detyrat e saj përgjegjëse për këto marrëveshje është Zyra e Karrierës & Alumni GVJ nuk gjeti evidencë lidhur me to. Nga takimet e zhvilluara GVJ konstaton se njësia bazë e shkencave kompjuterike është kujdesur për të mundësuar zhvillimin e këtyre praktikave profesionale pranë kompanive të biznesit. Megjithatë në këto takime nga ana e tyre u pohua edhe një punë më e madhe që duhet bërë për zgjerimin e numrit të bashkëpunimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim me koordinatorin e programit dhe duke shfrytëzuar edhe kontaktet personale të stafit akademik kanë vendosur edhe urat e bashkëpunimit institucional me kompani të biznesit dhe institucione shtetërore për kryerjen e praktikave profesionale.</p> <p>Aktualisht fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Crystal System, e cila ka qënë gjithnjë e pranishme me suportin e saj, në aktivitetin mësimor-kërkimor-shkencor të stafit dhe të studentëve. Mbikqyrja e tyre zhvillohet në terma periodike të percaktuar edhe në Rregulloren e FIT dhe të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit në kuadër të aftësimit të mëtejshem të studentëve ka organizuar edhe workshope për studentët, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Workshop I: Modelling and Animation – Aktiviteti i parë i stafit akademik dhe trajnimeve të studentëve i ndihmoi ata të mësonin tema

	<p>kryesore në animimin 3D dhe postproduksionin. Pas kësaj, studentët duhej të përgatishnin projektet praktike në Blender dhe After Effects.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Workshop II: Production and Postproduction techniques; Hands-on practice 								
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë e shkencave kompjuterike harton raporte vjetore analitike në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit [DVV evidence nr. 28 – Raporti analitik i përfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit];</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton Programi MPSHKA është organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 1 vit dhe në total 60 kredite. [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018] [dok DVV Evidenca Nr.9 – Kurrikula e programit MPSHKA, miratuar me vendim Senati në vitin 2018; Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit;]</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë MPSHKA, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara synon specializimin e studentëve në planifikimin, projektimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web profesionale, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike, krijimin, menaxhimin dhe administrimin e bazave të të dhënave; etj. [dok DVV Evidenca Nr.11–Dosja e plotë e programit të studimit; Evidenca Nr.12.1–Modeli i Diplomës dhe Supplementit]</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i Ciklit të Dytë të studimit MPSHKA plotëson njohuritë e studentëve në fushat “Programim” (fokusuar ne Web) dhe “Të dhënat dhe Analizimi” të Shkencave Kompjuterike, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushave “Programim” dhe “Të dhënat dhe Analizimi”. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Evidenca Nr.12.1 – Modeli i Diplomës dhe</p>

	Suplementit; Evidenca Nr.7 - Rregullore e programit të studimit; Syllabuset e lëndëve]			
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ndër objektivat formues të programit të ciklit të dytë të studimit MPSHKA janë përgatitja e studentëve me njohuri të reja për zbatimin e aplikacioneve, komunikimin dhe përgatitja e studentëve me njohuri të reja në menaxhimin e bazave të të dhënave, zhvillimin e softwareve, zhvillimin e website-ve, etj. GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet mjaft mirë dhe kjo rezultoi në shprehur qartë në programin mësimor dhe programet lëndore. [dok DVV DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit;], [dok DVV Evidenca Nr.9 – Kurrikula e programit MPSHKA, miratuar me vendim senati në vitin 2018; Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset e lëndëve].			
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga GVB GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë të studimit MPSHKA përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018 - Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]			
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i dosjes së programit të studimit rezultoi se programi i ciklit të dytë të studimit MPSHKA ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018. Secila prej lëndëve ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite ku çdo lëndë ka 6 kredite. Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese në leksione, seminare, dhe laboratore/praktikë.			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Pas shqyrtimit të dosjes së programit të studimit GVJ konstaton se është parashikuar ngarkesë në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, 6 kredite ose 150 orë pune për studentin. Numri i orëve për praktikën profesionale është në përputhje me përcaktimet në VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018. Gjithashtu për çdo lëndë programi ka të përcaktuara orë mësimore për praktikën laboratorike. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit;] [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 10, datë 07.04.2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e	Rezultoi se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit si njësi kryesore

<p>studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Matematikës (DM); • Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK); • Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI). <p>duke përmbushur kështu kriteret dhe detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.</p> <p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", si njësi kryesore brenda strukturës së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.</p> <p>[dok DVV Evidenca Nr.6 Rregullorja NjKTI].</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 48 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 20 janë me grada dhe tituj.</p> <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) i cili është përgjegjës për MP në "Shkenca Kompjuterike te Aplikuara" përbëhet nga 18 anëtarë të personelit akademik të brendshëm (PAE), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 me gradën 'Dr', - 15 Msc (4 në vazhdim të studimeve doktorale), <p>[Dok DVV Evidenca Nr. 18. Te dhena tabelore per personelin akademik ne NjKTI dhe NjBSHK]. [dok DVV Evidenca Nr.19 – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit 2016-2019; Evidenca Nr.20 – Tabela përmbledhëse për ngarkesën e personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar]</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur:</p> <p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 3 departamente, duke plotësuar kriterin ligjor.</p> <p>Çdo departament plotëson numrin minimal prej 7 pedagogësh nga të cilët të paktën janë 3 janë me tituj/grada sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Matematikës (DM) ka 15 anëtarë (9 me tituj/grada); • Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) ka 18 anëtarë (3 me tituj/grada); • Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka 15 anëtarë (7 me tituj/grada); <p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 48 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 20 janë me grada dhe tituj. Drejtuesi i njësisë kryesore është i kategorisë Profesor. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) përbëhet nga 18 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 3 zotërojnë gradën 'Doktor Shkencash'. Drejtuesi i departamentit është i kategorisë Doktor. [Dok DVV Evidenca Nr. 18. Te dhena tabelore per personelin akademik ne NjKTI dhe NjBSHK]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e</p>	<p>Nga bashkëpunimi me kompaninë 'Crystal System', Universiteti</p>

<p>studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>”Aleksandër Moisiu”, Durrës ka në përdorim 5 laboratorë, nga te cilët 3 janë në Fakultetin Teknologji Informacioni.</p> <p>Programi i studimit MPSHKA, ka në përdorim 2 nga këta laboratorë. Gjatë vizitës në institucion GJV konstatoi se në çdo laborator kishte një personel akademik ndihmës (laborant). Sipas RVB, studentët inkurajohen dhe drejtohen të realizojnë praktika profesionale në ambjentet e institucioneve bashkëpunuese në fushën e shkencave kompjuterike. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës nuk angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore: studentët e bëjnë praktikën në mënyrë të pavarur, dhe në fund të vitit akademik, paraqesin para një komisioni mbrojtjen e praktikës. [Dok DVV Evidenca Nr.26. Memorandum UAMD - Crystal System; Evidenca Nr.28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; RVB]</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në dokumentin ‘Dosja e plotë e programit të studimit’ përcaktohet koordinatori i programit MPSHKA (i zgjedhur nga Komiteti Shkencor). Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>[dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit MPSHKA është drejtuesi i departamentit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij. [dok DVV Evidenca Nr.29 - Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GJV konstaton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit e MPSHKA si: Rregulloren e programit mësimor, syllabuset orarin, Ngarkesën; dok i kërkuar gjatë vizitës, etj. [dok DVV Evidenca Nr.7. Rregullore per Program studimi SHKA], Evidenca Nr.24. te dhena tabelore per stafin akademik ne programin e studimin (eplotesuar)], [dok DVV Evidenca Nr.9–Kurrikula e programit MPSHKA, miratuar me vendim senati në vitin 2018; Evidenca Nr.11–Dosja e plotë e programit të studimit], [dok DVV Syllabuset], [dok DVV Evidenca Nr. 49. Orari Master FTI-SEM I II 18-19], [dok DVV Evidenca Nr.19–Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit 2016-2019; Evidenca Nr.20–Tabela përmbledhëse për ngarkesën e</p>

	personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar,																										
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM Nr. 41, Datë 24.1.2018. Bazuar në dokumentat e dërguar nga GVB, veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën mëposhtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria / Përshkrimi</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM 41</th> <th colspan="2">Programi ShKA</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A LËNDË BAZË</td> <td>5%-10%</td> <td>6</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>B LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>30% - 40%</td> <td>24</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>C LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE</td> <td>20%-30%</td> <td>12</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>D LËNDË PLOTËSUESE(Praktika)</td> <td>10%</td> <td>6</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>10%- 20%</td> <td>12</td> <td>20%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i dosjes së plotë të programit të studimit MPShKA, GVJ konstaton se programi përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5 lëndë të detyrueshme - 2 grup-lëndë me zgjedhje ku secila prej grup-lëndëve ka tre lëndë nga të cilat studenti zgjedh një prej tyre - Praktika - Provimi Përfundimtar. <p>Ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator/praktikë) paraqitet qartë. [dok DVV Evidenca Nr.9 – Kurrikula e programit MPShKA, miratuar me vendim senati në vitin 2018; Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]</p>	Kategoria / Përshkrimi	Përqindja Krediteve Sipas VKM 41	Programi ShKA		Kredite	%	A LËNDË BAZË	5%-10%	6	10%	B LËNDË KARAKTERIZUESE	30% - 40%	24	40%	C LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	20%-30%	12	20%	D LËNDË PLOTËSUESE(Praktika)	10%	6	10%	E DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 20%	12	20%
Kategoria / Përshkrimi	Përqindja Krediteve Sipas VKM 41			Programi ShKA																							
		Kredite	%																								
A LËNDË BAZË	5%-10%	6	10%																								
B LËNDË KARAKTERIZUESE	30% - 40%	24	40%																								
C LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE	20%-30%	12	20%																								
D LËNDË PLOTËSUESE(Praktika)	10%	6	10%																								
E DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 20%	12	20%																								
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në dy semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Ky program rezulton me 30 kredite për semestër, pra 60 kredite në një vit të plotë akademik. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Evidenca Nr.7 - Rregullore e programit të studimit]</p>																										
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>GVJ konstaton se dosja e plotë të programit të studimit MPShKA përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset. Mënyra e vlerësimit të dijeve në një lëndë [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provim i ndërmjetëm (i cili ka 400 pikë të mundshme), - detyrë kursi (e cila ka 100 pikë të mundshme) - provimi përfundimtar (i cili ka 500 pikë të mundshme) <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th> <th>Sistemi i vlerësimit (Nota)</th> <th>Përqindja</th> <th>Pikët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)</td> <td>10</td> <td>94-100%</td> <td>935-1000</td> </tr> <tr> <td>B (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>9</td> <td>85-93%</td> <td>845-934</td> </tr> </tbody> </table>	Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët	A (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000	B (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934														
Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët																								
A (Shkëlqyeshëm-performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000																								
B (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934																								

	<table border="1"> <tr> <td>C+ (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)</td> <td>8</td> <td>76-84%</td> <td>755-844</td> </tr> <tr> <td>C (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>7</td> <td>67-75%</td> <td>665-754</td> </tr> <tr> <td>D (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)</td> <td>6</td> <td>58-66%</td> <td>575-664</td> </tr> <tr> <td>E (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kritereve minimale)</td> <td>5</td> <td>51-57%</td> <td>505-574</td> </tr> <tr> <td>FX (Ngel-kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)</td> <td>4</td> <td>≤50%</td> <td>0-504</td> </tr> </table> <p>[dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit] [dok DVV Evidenca Nr.7 - Rregullore e programit të studimit] [dok DVV Syllabuset]</p>	C+ (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844	C (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754	D (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664	E (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kritereve minimale)	5	51-57%	505-574	FX (Ngel-kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504
C+ (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844																		
C (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754																		
D (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664																		
E (Mjaftueshëm-performanca u përmbahet kritereve minimale)	5	51-57%	505-574																		
FX (Ngel-kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504																		
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se dosja e plotë e programit të studimit MPSHKA përmban informacion në lidhje me pranimin e studentëve në rubrikat “Kriteret e Pranimit” dhe “Programet e studimit të ciklit të parë që mundësojnë pranimin në programin e studimit”. Kriteret e pranimit të studentëve janë [cit]:</p> <p>Masteri është projektuar për studentët të cilët kanë përfunduar tashmë një program studimi Bachelor dhe janë diplomuar me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Diplome Bachelor në “Shkenca kompjuterike”, 2) Diplome Bachelor në “ Teknologji Informacioni”, 3) Diplome Bachelor në “Sisteme Informacioni” 4) Diplome Bachelor në “Matematikë-Informatikë” 5) Diplome Bachelor në “Informatikë-Anglisht” <p>Rregullorja e programit të studimit MPSHKA, përmban informacion që lidhet me transferimin e studimeve. Në këtë rregullore përcaktohet se: Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, në programin e studimit MPSHKA, merret nga komisioni ad-hoc përkatës, i ngritur nga njësisia dekanati i fakultetit.</p> <p>[dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit], [dok DVV Evidenca Nr.7 - Rregullore e programit të studimit, Neni 36]</p>																				
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se shumica e elementëve strukturor të kërkuar në VKM nr. 41, dt. 24. 01. 2018 janë paraqitur në shumicën e syllabuseve të lëndëve.</p> <p>Elementët e veprimtarisë mësimore (leksion, seminar, laborator) nuk janë paraqitur në syllabuse, megjithatë ato gjenden në dosjen e plotë të programit të studimit MPSHKA</p> <p><i>Sugjerime:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të rishikohen syllabuset duke shtuar informacion për Elementët e veprimtarisë mësimore (leksion, seminar, laborator). (Jo të gjitha syllabuset janë sipas formatit të përcaktuar në VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018 (p.sh. syllabuset e lëndëve “Teori Kodimi” dhe “Databazë e Avancuar”). - Të rishikohen syllabuset e dërguara sipas formatit në VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018 për ndonjë pasaktësi të mundshme (p.sh tek 																				

	<i>elementi: Tipologjia e lëndës)</i>			
	[dok DVV Syllabuset], [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit].			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Sipas RVB çdo vit të ri akademik Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike angazhon koordinorët e programeve të studimit të mbledhin syllabuset e përditësuar me tema dhe literatura të reja bashkëkohore për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike. Këto përmirësime nuk i kalojnë 20% të ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Gjatë vizitës në institucion, intervista me stafin akademik, u theksua se çdo semester stafi mblidhet për të diskutuar në lidhje me syllabuset dhe ndryshimet që mund të bëhen në të. GVJ konstaton se syllabuset e dorëzuara sipas formatit të ri mbajnë datën Tetor 2018. [Dok DVV RVB], [Vizita në Institucion-Shënime: Takim me Stafin akademik te programit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në 1 vit akademik, me 60 kredite në total. Konstatohet se është në përputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit MPSHKA është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Praktikant mësimore në institucionet bashkëpunuese dhe praktikant laboratorike në labororet e programit mundësojnë praktikimi e njohurive. Në lidhje me sa më lart, GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike.[dok DVV Evidenca Nr. 27. Marreveshjet institucionet bashkëpunuese; Vizita në Institucion-Shënime: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit].
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit MPSHKA dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset] [Vizita në Institucion-Shënime]
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë në

<p>ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>përputhje me profilin e programit të studimit MPSHKA dhe të domosdoshme për formimin e specialistëve në fushat “Programim” (fokusuar ne Web) dhe “Të dhënat dhe Analizimi” të Shkencave Kompjuterike. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset]</p>			
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se raportet midis formimit teorik dhe praktik janë të përshtatshme për arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike, krijimin, menaxhimin dhe administrimin e bazave të të dhënave. Gjatë intervistave më personelin akademik dhe me studentët evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik pas riorganizimit të programit të studimit janë të përshtatshme.</p> <p>[dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit] , [Vizita në Institucion-Shënime: Takim me Studentët; Takim me Stafin akademik te programit]</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Sipas RVB, çdo vit të ri akademik Përgjegjësi i Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike angazhon koordinatorët e programeve të studimit të mbledhin syllabuset e përditësuara me tema dhe literatura të reja bashkëkohore. GVJ konstaton se në syllabuset e dorëzuara sipas formatit të ri në literaturën e rekomanduar ka literaturë që nuk i përket 5 viteve të fundit.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit MPSHKA ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli master. [Dok DVV RVB] [Dok DVV syllabuset] , [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset]</p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit MPSHKA u jep mundësi studentëve të pozicionohen më së miri në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit MPSHKA duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushat “Programim” (fokusuar ne Web) dhe “Të dhënat dhe Analizimi” të Shkencave Kompjuterike. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset]</p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit synon të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Gjatë intervistave në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës GVJ konstatoi se biznesi kishte eksperiencë të mirë me të diplomuarit e programit të studimit MPSHKA. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset] [dok Vizita në Institucion – Shënime] [Vizita-Takimi me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se:</p> <p>Personeli akademik që u angazhua në programin e studimit gjatë vitit akademik 2018-2019 është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 me kohë të plotë (të gjithë janë me tituj /grada). - 3 me kohë të pjesshme (të gjithë me tituj/grada). <p>Raporti PAE/PAK është 7/3 (70%/30%)</p> <p>Personeli akademik që u angazhua në programin e studimit gjatë vitit akademik 2019-2020 është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 me kohë të plotë (të gjithë me tituj/grada) - 0 me kohë të pjesshme. <p>Raporti PAE/PAK është 8/0 (100%/0%)</p> <p>GVJ konstaton se përmbushen kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>[dok DVV Evidenca 19. Të dhëna tabelore për stafin akademik në programin e studimit; Evidenca 20. Të dhëna tabelore për ngarkesën e stafit] [dok i kërkuar gjatë vizitës Evidenca Nr.24. të dhëna tabelore për stafin akademik në programin e studimit (eplotësuar)]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Modulet mësimore në programin MPShKA mbulohen nga pedagogë të cilët kanë gradë shkencore. Bazuar në dokumentacionin stafi në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2018-2019 ishte si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Prof. Dr • 1 Prof. Asoc. Dr • 8 Dr <p>Stafi në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2019-2020 është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Prof. Asoc. Dr • 7 Dr <p>[Dok DVV Evidenca 19. Të dhëna tabelore për stafin akademik në programin e studimit; Evidenca 20. Të dhëna tabelore për ngarkesën e stafit;] [dok i kërkuar gjatë vizitës Evidenca Nr.24. të dhëna tabelore për stafin akademik në programin e studimit (eplotësuar)]</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në programin e studimit MPShKA gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi tepër të larta.</p> <p>[dok DVV Evidenca Nr. 16. cv stafi MP dhe Evidenca CV stafi e përditësuar e</p>

	kërkuar gjatë vizitës]			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Në këto marrëveshje janë përcaktuar dhe hapësirat për realizimin e praktikave të studentëve. Sipas RVB, koordinatorët e programit të studimit kujdesen nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me personat përgjegjës të biznesit për të monitoruar mënyrën sesi po kryhet praktika profesionale. [dok DVV Evidenca 27. Marrëveshjet institucionet bashkëpunuese]			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e Universitetit (klasat /labororet ku bëhet mesim nga studentet e programit të studimit MPShKA, GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhej nga personeli ndihmësimor-shkencor. Përveç mirëmbajtjes, personelit ndihmës – akademik me karakter mësimor, laborantët mbështesin stafin akademik gjatë orës së mësimin në laborator. Nga shqyrtimi i CV-ve ky personel është i përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike. [Vizita në Institucion-Shënime], [dok DVV Evidenca Nr. 17. stafi ndihmes]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përfshirjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës, konkretisht kompania Crystal System dhe Co-Founder Pragmatic Software. [dok DVV Evidenca Nr.14 – Studimi periodik për tregun e punës; Evidenca Nr. 28.Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve]
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistat gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se studentët përfshihen në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Studentët janë shpehur në një pyetësor të realizuar në vitin 2018 se mjetet dhe pajisjet në institucion janë të pamjaftueshme Institucioni ka marrë manaxhuar këtë problematikë të ngritur nga studentët duke pajisur Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit me tre laboratorë. Sipas RVB , Departamenti i shkencave Kompjuterike organizon mbledhje për të marrë mendimin e studentëve në

programit të studimit.	lidhje me procesin e mësimit dhe gjatë procesit mësimit, koordinatori i programit të studimit bashkëbisedon me studentët për problematikat që ata mund të kenë. [dok DVV Evidenca Nr.32 – Anketimi I studentëve, dhe stafi akademik;]			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Bazuar në RVB dhe intervistat gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se studentët e diplomuar kontaktohen në adresat e tyre të e-mail nga Dega e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit. Atyre u dergohen njoftime të ndryshme apo pyetësor. Mendimi i tyre, se mjetet dhe pajisjet në institucion janë të pamjaftueshme, është marrë parasysh nga institucioni i cili ka shtuar 5 laboratorë në ndihmë të procesit mësimit.[dok DVV Evidenca Nr.32 – Anketimi i studentëve, dhe stafi akademik;] [Vizita – Shënime]			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës ofron programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale. Sipas RVB, për të qënë koherent me atë çfarë nevojitet në treg Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës çdo vit bën një studim tregu për nevojat dhe kërkesat. Programi MPSHKA është riorganizuar në 2018. [dok DVV Evidenca Nr. 40. Vendimi i riorganizimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimit dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimit në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës në strategjinë e tij përcakton se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë mbështet rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimit dhe të nxënies. Në planin strategjik të Programit MPSHKA përcaktohet se ndër qëllimet strategjike është “Të përmirësohet më shumë stafi akademik, duke i trajnuar ata herë pas here me metodat më të fundit të mësimit” dhe ndër veprimet për arritjen e këtij qëllimi është “Të zhvillohen dhe ndiqen programe trajnimi për stafin akademik të departamentit të Shkencave Kompjuterike, në mënyrë që të zbatohen metodikat e fundit të mësimit”. Në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni nuk është paraqitur një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimit. [dok DVV Evidenca Nr.2 – Statuti i Universitetit “Aleksander Moisiu”, Kreu VII, Neni 78;], [dok DVV Evidenca Nr.4 – Plani

	Strategjik për zhvillimin programit të studimit, Strategjia I, Objektiv 2-b)			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstaton se një nga prioritetet strategjike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës është “Garantimi i përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve” Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik [dok DVV Evidenca Nr.3 – Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD për periudhën 2016 – 2020]. [dok DVV dok DVV Evidenca Nr.5 – Rregullorja e Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, Neni 115, pika 1, dh; Evidenca Nr.32. Anketimi studenteve dhe i lektoreve 2017 – 2018; dok i kërkuar gjatë vizitës Pyetesori i studenteve, format, shembull pyetesori, shembull raporti vleresimi.pdf]			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës garanton në rregulloren e tij përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të lektoreve dhe mënyrës së realizimit të mësimdhënies nga ana e studentëve. Ky vlerësim merret me anë të pyetësorëve nga Dega Mësimore dhe Sektori i Kurrikulave pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Çdo student duhet të plotësojë në mënyrë anonime këtë pyetësor për çdo lektor të kurseve që zhvillon në atë semester. Ky pyetësor realizohet në të dy semestrat e vitit akademik. [dok DVV Evidenca Nr.5 – Rregullorja e Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, Neni 115, pika 1, dh;]			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përgjigjet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë Rezultatet e pyetësorëve skanohen me anë të lexuesit optik, përpunohen dhe ju bëhen të ditura fakulteteve dhe njësisive bazë përkatëse. Një raport individual gjenerohet për secilin anëtar të stafit akademik dhe i komunikohet me email duke ruajtur privatësinë e informacionit. [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19] [dok DVV Evidenca Nr.32 – Anketimi i studentëve, dhe stafi akademik;]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ, në bazë të dokumentit konstaton se rezultatet e vlerësimit të klësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport në nivel institucioni. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. [dok DVV Evidenca Nr.32 – Anketimi I studentëve, dhe stafi akademik;.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve,

<p>njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Sipas planit mësimor të paraqitur në Dosjen e plotë të programit rezultojnë këto ngarkesa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione: 224 orë mësimore - Seminare 112 orë mësimore - Laboratore 84 orë mësimore - Aktivitete të tjera (detyra, etj) 175 orë mësimore <p>Megjithatë në takime u deklarua se UAMD ndjek modelin amerikan për zhvillimin e orëve të pa ndara në elementët e mësipërm. Pedagogët e bëjnë ndarjen në varësi të situatës.</p> <p>Syllabusët e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Kreu III, Neni 60, Për Organizimin e Studimeve. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabusët; Evidenca Nr.5 – Rregullorja e Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, Kreu III, Neni 60]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit MPShKA ka marrë pjesë në trajnimet në kuadër të projekteve të financuara nga Erasmus+. Këto trajnime mund të nxitin përdorimin e metodave inovative të mesimdhënies. Disa nga metodat e përdoruar gjatë procesit mësimor janë: puna në grup, prezantimet e punimeve të studentëve, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer analiza të pavarura etj. [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik duke lidhur marrëveshje mobilitetesh me universitetet tjera në kuadër të programit Erasmus+. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i MPShKA mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. [dok DVV Evidenca Nr. 27. Marrëveshjet institucionet bashkepunuese; Evidenca Nr. 42. Marrëveshjet per mobilitet Erasmus - Insterintitution Agreement 2014-2021 and 2015-2021 for mobility for learners and staff]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit MPShKA posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. [dok DVV Evidenca Nr. 16. cv stafi MP dhe Evidenca CV stafi e përditësuar e kërkuar gjatë vizitës]</p>

Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga studentët, kjo nëpërmjet pyetësorëve të hartuar në mënyrë periodike. Stafit u shpreh gjatë vizitës në institucion se rekomandimet për përmirësimin e programit të studimit nga studentët janë marrë parasysh nga institucioni. [dok DVV Evidenca Nr.32. Anketimi studenteve dhe i lektoreve 2017 – 2018; dok i kërkuar gjatë vizitës Pyetësori i studenteve, format, shembull pyetësori, shembull raportit vlerësimi]. [Vizita në Institucion]			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Integrimi i praktikës me konceptet teorike të nevojshme, nxitja e studentëve për të realizuar projekte praktike individuale ose në grup, të cilët prezantohen përpara studentëve të tjerë por jo vetëm ka nxitur pjesëmarrjen e studentëve dhe ndërveprimin në orën e mësimin. [dok DVV Evidenca Nr.11–Dosja e plotë e programit të studimit;], [Vizita në institucion]			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Detyrat e kursit, projektet ndërdisiplinore praktike individuale ose në grup, të cilët prezantohen përpara studentëve të tjerë por jo vetëm ka inkurajuar sensin e autonomisë të studentit. Diskutimi në orën mësimore siguron udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi për realizimin me sukses të tyre. [Vizita në institucion –Takimi me stafin akademik të programit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ pas vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit MPSHKA realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës deklaroi numrin e studentëve që kanë studjuar në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit gjatë viti akademik 2018-2019. [dok DVV 33. Te dhena per infrastrukturen UAMD FORMULARI KAPACITETEVE 2018-2019], [Vizita në Institucion- Shënime]
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Bazuar në dokumentacion së fundmi janë vënë në dispozicion të programit të studimit MPSHKA dy laboratore, të cilat i shtohen laboratorit ekzistues kompjuterik. Keto laboratore përmbajnë softuare-t e nevojshme për lëndët që ofron kurrikula e programit të studimit MPSHKA. [Dok DVV Evidenca Nr.26. Memorandum UAMD - Crystal System; Evidenca Nr.28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; RVB]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Gjatë vizitës në Universitetin “Aleksander Moisiu”, Durrës GVJ konstatoi se. në godinën e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit infrastrukturë IT është e konsoliduar dhe mbështet realizimin e procesit mësimor. Sallat janë të pajisura me mjete të ndryshme audiovizive, projektorë, kompjutera. Sipas personeli akademik dhe studentët mund të shfrytëzojnë një sistem të integruar bibliotekar “KOHA” dhe një modul sistemi të integruar,

	Katalogu Online, për menaxhimin e fondit të Bibliotekës Shkencore. Personeli akademik dhe studentët mund të shfrytëzojnë gjithashtu bibliotekën online të ofruar nga RASH. [Dok DVV Evidenca Nr. 45. Biblioteka Online (manual)] [Dok DVV Evidenca Nr. 44. Rregullorja e Bibliotekës UAMD] [Vizita në Institucion]
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Pedagogu i lëndës i vë në dispozicion studentëve, literaturën bazë dhe ndihmëse që do të përdoret për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Këto materiale janë në formë elektronike ose të printuara. Gjithashtu këto materiale janë edhe në bibliotekën e Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës. Duke qënë se programi i studimit MPSHKA formon specialist në një fushë që zhvillohet me hapa shumë të shpejtë ka vështirësi në gjetjen e librave në gjuhën shqipe. [dok DVV Evidenca Nr.34 – Lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), në funksion të programit; Evidenca Nr.44 – Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca Nr.45 - Biblioteka Online; GVB; Vizita në institucion].
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë Procesit mësimor.	Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës nuk përmban literaturën bashkëkohore dhe të mjaftueshme për fushën e shkencave kompjuterike. Studentët e programit të studimit MPSHKA mund të aksesojnë në sallën e kompjuterave materialet dixhitale. [dok DVV Evidenca Nr.44 – Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca Nr.45 - Biblioteka Online; GVB] [Vizita në Institucion]
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka mundëson kërkim të informacionit on-line, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës. Katalogu Online i Integruar, ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri lexuesit përfituan akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë me cilësi të lartë. Që prej muajit tetor 2009, në bibliotekën e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës mbërrijnë periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. [dok DVV Evidenca Nr.44 – Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca Nr.45 - Biblioteka Online; GVB; dok të kërkuara gjatë vizitës: Marreveshje bashkepunimi me Rosetta stone + Biblioteka; Linku i Databases së Bibliotekës Materialeve; Konfirmimi për marrjen e botimeve nga BSH], [GVB], [Vizita në Institucion]
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Studentët e programit MPSHKA mund të përdorin 3 laboratorë në FTI. Në këta laborator ka edhe programe specifike. Pranë laboratorëve gjatë gjithë orarit ndodhet staf ndihmës jo akademik i cili ka experience të gjerë në fushën e Shkencave Kompjuterike. [Dok DVV Evidenca Nr.26. Memorandum UAMD - Crystal System; Evidenca Nr.28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; RVB]
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin	Google Drive ose One Drive përdoret kryesisht nga lektorët dhe studentët për të komunikuar ndërmjet tyre dhe për të shkëmbyer materialet

akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	mësimore. Për të marrë informacion mbi vlerësimin final në provime, regjistrimin e kurseve dhe orarit të mësimit studentët përdorin sistemin online AULA. [dok DVV Evidenca Nr.35 –Udhezues per përdorimin e Struktures se Teknologjise se Informacionit;]			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sistemi online AULA përdoret në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për të marrë informacion mësimor lidhur me të dhënat e regjistrimeve, orarin online, notat, lëndët etj.[dok DVV Evidenca Nr.35 – Udhezues per përdorimin e Struktures se Teknologjise se Informacionit;]			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentët e programit të studimit MPSHKA kanë si detyrim përmbyllës provimin e formimit final. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit;]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Bazuar në dokumentacion institucioni ka përcaktuar si strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel institucional:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik • Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) • Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) • Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) <p>Këto struktura bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel të njësisë kryesore të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Njësia kryesore) • Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) • Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP/ Ko.Msc.) <p>[dok DVV Evidenca Nr.8 – Rregullorja e NJSBC, neni 2]</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Nga shqyrtimi dokumentacionit GVJ konstaton se dekani ngre Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të cilësisë të cilat janë përgjegjëse për procesin e vetëvlerësimit. Njsbc në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga Njsbc në nivel Institucional. Me anë të pyetësorëve që realizohen në të dy semestrat e vitit akademik tek studentët për vlerësimin

	periodik të lektorëve dhe mënyrës së realizimit të mësimdhënies institucioni rrit vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron. [dok DVV Evidenca Nr.8 – Rregullorja e NJSBC]
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Gjatë vizitës në institucion stafi u shpreh i kënaqur me mbështetjen që njësitë përgjegjëse u kanë dhënë në zbatimin e ideve të tyre gjatë mësimdhënies. Konkretisht futja e një projekti ndërdisiplinor, ndërmjet disa lëndëve në program, dhe paraqitja e tyre nga studentët përpara mësimdhënësve, përfaqësues të biznesit dhe studentëve të tjerë është mirëpritur dhe aktualisht është pjesë e mësimdhënies në këtë program. [Vizita në Institucion - Takim me Stafin e Programit]
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se institucioni inkurajon kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Njësia i kërkon stafit akademik të marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare gjatë një semestri. Njësia kryesore organizon një konferencë shkencore [Vizita në institucion – Takim Stafin akademik] [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19].
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Njësia kryesore ka marrëveshje të ndryshme institucionale pjesë e të cilave janë dhe trajnimet për stafin akademik. Gjatë vitit 2018-2019 stafi ka marrë disa trajnime. Stafi përdor metoda inovative gjatë mesimdhënies. Disa nga metodat e përdorura gjatë procesit mësimor janë: puna në grup, prezantimet e punimeve të studentëve, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer analiza të pavarura etj. [dok DVV Evidenca Nr. 27. Marreveshjet institucionet bashkepunuese; Evidenca Nr. 42. Marreveshjet per mobilitet Erasmus - Interinstitution Agreement 2014-2021 and 2015-2021 for mobility for learners and staff], [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19].
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Personeli akademik përdor metoda inovative gjatë mesimdhënies. Disa nga metodat e përdoruar gjatë procesit mësimor janë: puna në grup, prezantimet e punimeve të studentëve, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer analiza të pavarura etj. [dok DVV Evidenca Nr.19 – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit 2016-2019; Evidenca Nr.20 – Tabela përmbledhëse për ngarkesën e personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar; dok i kërkuar gjatë vizitës Evidenca Nr.24. te dhena tabelore per stafin akademik ne programin e studimin (eplotesuar)]
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19]. [Vizita në institucion – Takim Stafin akademik]
Kriteri 8. Institucioni në kuadër	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës përfshin në procesin mësimor

të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	lektorë dhe kërkues shkencorë nga institucionet me të cilat bashkëpunon si IAL. [dok DVV Evidenca Nr.19 – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit 2016-2019; Evidenca Nr.20 – Tabela përmbledhëse për ngarkesën e personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.; dok i kërkuar gjatë vizitës Evidenca Nr.24. te dhena tabelore per stafin akademik ne programin e studimin (eplotesuar)]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. [dok DVV Evidenca Nr.6– Rregullorja NjKTI, Neni 52;]. [dok DVV Syllabuset]			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabuset të cilat përmbajnë edhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik nga mësimdhënësi i lëndës. [Vizita në Institucion –Takimi me studentët] [dok DVV Syllabuset],			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, përcaktohen në pikën 6 të nenit 52 të rregullores së Njësisë Kryesore Në të përcaktohet se studenti vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë kohëzgjatjes së kursit duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Pjesë e vlerësimit janë gjithashtu detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit. [dok DVV Evidenca Nr.6– Rregullorja NjKTI, Neni 52, pika 6;]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	GVJ ka shqyrtuar rregulloren e Njësisë Kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, ku ofrohet programi i studimit MPSHKA dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet

<p>vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Në të përcaktohet se nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të tre elementeve: Provimit të ndërmjetëm (40%); Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit (10%); Provimit përfundimtar (50%). [dok DVV Evidenca Nr.6–Rregullorja NjKTI, Neni 52, pika 6;]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Aktualisht testimi dhe vlerësimi në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës është realizuar duke kombinuar metodat tradicionale (“pencil and paper”, vlerësimin me gojë) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) për instalimin e platformës dixhitale dhe barkodeve për sekretimin dhe leximin elektronik të testeve si dhe për përkthimin e teksteve fundamentale. Parashikohet që në vitin 2020, të nisët korrigjimi i provimeve të diplomës, meqë në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës aplikohen pyetjet me zgjedhje në këto testime. [Vizita në Institucion], [dok DVV RVB]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas RVB, vlerësimi përfundimtar i studentëve gjatë sezonit të rregullt të mësimin bëhet nga lektori i kursit. Në rregulloren e njësisë bazë përcaktohet se riprovimet vlerësohen nga një komision. Sipas RVB, komision ka në përbërje tre lektorë që kanë formimin specifik, ose kanë zhvilluar module të ngjashme. Titullari i kursit është kryetar i komisionit kurse dy lektorët e tjerë janë anëtarë të tij. [dok DVV Evidenca Nr.7. Rregullore për Program studimi SHKA, Neni 26, Organizimi i Sezoneve të riprovimeve] [dok DVV RVB]</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Sipas RVB, dhe nga vizita në sekretari e GVJ u kontaktua se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka një proces sekretimi në të cilin përdoret një format i fletëve ku mund të realizohet mos njohja e identitetit të studentit deri në momentin që studenti vjen dhe e identifikon vetë fletoren dhe vendos emrin e tij/saj në fletore. Fletoret pasi korigjohen duhet të hapen nga sekretaria dhe pedagogu njeh pikët për secilin student. Ky sistem paraqet vështirësi në aplikim. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës po përmirëson procesin e sekretimit të provimeve nëpërmjet përdorimit të metodave të reja me kode shifrore dhe lexues optik të përgjigjeve. Duke filluar që nga sezoni i ardhshëm i diplomave ky sistem do të jetë operativ edhe në këtë program studimi. Aktualisht po zhvillohen seancat e trajnimit me personelin ndihmës për administrimin e procesit. [Vizita në sekretari]</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB, dhe nga takimi me stafin akademik, pedagogu plotëson pjesë të ndryshme të pyetjeve që studentin nuk i ka bërë saktë dhe as të plota kur korigjon testet. Vlerësimi i testeve shoqërohet me komente dhe feedback nga pedagogu. Një seancë sqaruese zhvillohet pas testit të ndërmjetëm dhe atij final. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilesinë e punimeve të tyre. Në rastin e detyrave të kursit pedagogu bën komente direkte të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij procesi. [Takimi me studentët]</p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se në pikën 3 d të nenit 88 të rregullores së Fakultetit konsiderohet shkelje nga ana e studentit kopjimi, plagjiatura apo paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri dhe ndaj tij ndërmerren masa ndëshkimore. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e stafi akademik të kursit si dhe stafit akademik asistues, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. [dok DVV Evidenca Nr.6 –Rregullorja NjKTI, neni 88,); [dok DVV Evidenca Nr.6– Rregullorja NjKTI, Neni 53, pika 3 dhe 5]</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka përcaktuar në se dita e vendosur për rezultatet e provimit duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. [dok DVV Evidenca Nr.6 – Rregullorja NjKTI, Neni 53, pika 7]</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka përcaktuar në se “Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të stafit akademik të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar stafi akademik i kursit cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar.” [dok DVV Evidenca Nr.6 – Rregullorja NjKTI, Neni 53, pika 7]</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka përcaktuar në se “<i>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Rishikimi i tezës realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit nga komisioni ad-hoc. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyrojnë vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e kursit duke ndjekur procedurat përkatëse.</i>” [dok DVV Evidenca Nr.6 – Rregullorja NjKTI, neni 56;]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Njësitë përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të</p>	<p>Bazuar në dosjen e tij dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, programi MPShKA synon zhvillimin e dijeve të studenteve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushat “Programim” (fokusuar ne Web) dhe “Të dhënat dhe Analizimi” të Shkencave Kompjuterike. [dok DVV Evidenca</p>



veçanta të studentëve.	Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit MPSHKA zhvillon aftësi të veçanta në drejtime të fushës së Shkencave Kompjuterike “Programim” (fokusuar ne Web) dhe “Të dhënat dhe Analizimi”. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive komunikuese të dhe të të punuarit në grup. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit; Syllabuset], [dok DVV Syllabus Menaxhim projektsh-syllabus formati i ri]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas RVB, dhe nga takimi me koordinatoren e programit dhe stafin akademik çdo vit akademik, lektorët përpara fillimit të procesit të mësimdhënies shprehin mendimin e tyre për të ndryshuar përmbajtjen e lëndës, temave të saj, deri në 20%. Të gjitha këto propozime diskutohen nga stafi akademik në mbledhjet e njësisë bazë dhe reflektohen për të pasqyruar azhornimet dhe teknologjitë inovative bashkëkohore. [Takim me stafin akademik]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Sipas RVB, dhe nga takimi me stafin akademik, u konstatua se në përfundim të çdo lënde pedagogu i saj bën një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme duke i orientuar në lidhje me provimin përfundimtar, zbatimin e tyre në praktikë si dhe sjell raste studimi nga eksperiencia e tij profesionale. Ka syllabuse që parashikojnë seanca speciale për përsëritjen e lëndës, pra evidentimin e temave më të rëndësishme me sqarimet e nevojshme. [dok DVV Sistemet Multimediale-syllabus-formati i ri]
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se sipas analziës vjetore të departamentit të Shkencave Kompjuterike zhvillimi i Leksioneve të Hapura ka qënë një aktivitet i zhvilluar nga disa lektorë të departamentit. Gjithashtu janë realizuar workshop të ndryshëm p.sh. për teknologjitë multimediale me të ftuar nga institucionet bashkëpunuese. [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19] [dok DVV Evidenca Nr.28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Nga vizita në institucion GVJ konstaton se në ndërtimin e moduleve personeli akademik bazohet në kërkesat e tregut të punës të përkthyer në nivel kompetencash për secilin modul. Studentit i jepet mundësi të zbatojë këto kompetenca në laboratorë. dhe në praktikat profesionale të parashikuara në programin e studimit MPSHKA [dok DVV Evidenca Nr.14. Studim i tregut të punës pas daljes] [dok DVV Syllabuset; Vizita në institucion]
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se detyrat e kursit janë pjesë e lëndëve të programit të studimit MPSHKA. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se personeli akademik nxit e studentët për të realizuar projekte praktike individuale ose në grup, të cilët prezantohen dhe diskutohen me studentët e tjerë dhe mësimdhënësin. [dok DVV Syllabuset], [Vizita në institucion]
Kriteri 8. Personeli akademik krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative,	Projektet praktike individuale ose në grup [Vizita në institucion] dhe detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të çdo lëndë krijojnë klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative.

studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Gjithashtu lektorët e departamentit ndihmojnë studentët të paraqesin me se miri punimet e tyre në workshop-et studentore të organizuara [dok DVV Syllabuset] [dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19]			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës mbështet zhvillimin e ideve inovatore duke organizuar workshope studentore dhe inkurajuar pjesëmarrjen e studentëve në konferenca. Në workshopet studentore marrin pjesë përfaqësues të bizneseve apo kompanive të ndryshme, në mënyrë që studentëve t’u ofrohet praktikë profesionale, internship, apo edhe punësim i mirëfilltë. [dok DVV 30.1. Raporti mbi aktivitetin Kerkimor Shkencor; dok DVV Evidenca Nr.31. analiza vjetore per dept per Arritjen e objektivave 18-19]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ ka konstatuar se UAMD, ka një sërë marrëveshjesh në kuadër të projekteve ERASMUS+. Këto marrëveshje mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perendimore. Ato mundësojnë gjithashtu mobilitetin e studentëve dhe mbështetjen e tyre për të kryer një pjesë të studimeve jashtë njësisë kryesore [dok DVV Evidenca Nr. 42. Marreveshjet per mobilitet Erasmus - Insterintitution Agreement 2014-2021 and 2015-2021 for mobility for learners and staff]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka vënë në dispozicion të programit të studimit MPSHKA 3 laboratorë, të cilët përmbajnë softuare-t e nevojshme për lëndët që ofron kurrikula e programit të studimit MPSHKA studentët realizojnë praktika profesionale në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në fushën e shkencave kompjuterike. [Dok DVV Evidenca Nr.26. Memorandum UAMD - Crystal System; Evidenca Nr.28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; RVB; Vizita në institucion] [Dok DVV Evidenca Nr.27. Marreveshjet institucionet bashkepunuese]
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, në bashkëpunim me institucione me të cilët ka lidhur marrëveshje ka garantuar realizimin e praktikave mësimore për studentët e programit të studimit MPSHKA. [Dok DVV Evidenca Nr.27. Marreveshjet institucionet bashkepunuese]
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në	Programi i studimit MPSHKA ka në planin e tij mësimor praktikën profesionale e cila ka 6 kredite. Sipas RVB, studenti duhet të dokumentojë punën e përditshme apo të paraqesë një projekt konkret të



kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	punuar me teknologjitë e përdorura në kompanine e zgjedhur. Raporti vlerësues që jep përfaqësuesi i kompanisë ndikon në vlerësimin e praktikës, i cili bazohet gjithashtu edhe në prezantimin e punës së kryer nga studenti. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti Shkenca Kompjuterike në rregulloren e tij ka përcaktuar rregullat e vlerësimit të tezës së diplomës dhe të fitimit të diplomës MPSHKA. Departamenti Shkenca Kompjuterike në rregulloren e tij ka përcaktuar se provimi formues për mbrojtjen e Diplomës përmban pyetje nga disa nga kurset që janë zhvilluar gjatë programit mësimor dhe se këto kurse përzgjidhen nga komisioni me vendim të njësisë bazë. Sipas RVB, dhe nga takimi me stafin akademik, u konstatua se çdo lektor kursi, thekson vazhdimisht gjatë mësimdhënies pikat ku studentit duhet të fokusohet më shumë për mbrojtjen e diplomës. Studentëve u vendoset në dispozicion një listë me pyetje/ushtrime nga kurset e përzgjedhura. Lista me pyetje/ushtrime për disa programe studimi gjenden online në faqen zyrtare të UAMD. [dok DVV Evidenca Nr.7 – Rregullore për Program studimi, Neni 19, 20 dhe 21], [https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së departamentit kurset nga të cilat janë pytet që përmban provimi final përzgjidhen nga komisioni me vendim të njësisë bazë. Program i provimit final hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. [dok DVV Evidenca Nr.7 –Rregullore për Program studimi, Neni 19]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Studentët e MPSHKA kanë si detyrim përmbyllës provimin e formimit final.. Programi i provimit final hartohet nga stafi i njësisë bazë, ku personeli akademik dorëzon pranë departamentit, një set pyetjesh dhe ushtrimesh, sipas specifikës së disiplinës përkatëse; Sipas RVB, programi i provimit të formimit u bëhet i njohur studentëve në fillim të vitit akademik dhe çdo lektor kursi, thekson vazhdimisht gjatë mësimdhënies pikat ku studentit duhet të fokusohet me shumë për mbrojtjen e diplomës. [dok DVV Evidenca Nr.11–Dosja e plotë e programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të</p>	<p>Studentët e MPSHKA kanë si detyrim përmbyllës provimin e formimit final. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit].</p>

temave dhe fushës së studimit.				
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët e MPSHKA kanë si detyrim përmbyllës provimin e formimit final. [dok DVV Evidenca Nr.11 – Dosja e plotë e programit të studimit].			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Departamenti Shkenca Kompjuterike në rregulloren e tij ka përcaktuar rregullat e vlerësimit të provimeve përfshirë edhe provimin formues. Sipas kësaj rregulloreje në përfundim të provimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. [dok DVV Evidenca Nr.7 –Rregullore per Program studimi, Neni 22]			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në rregulloren e tij ka të përcaktuar rregullat e fitimit të diplomës Në përfundim të programit të studimit MPSHKA, studenti pajiset me diplomën e regjistruar nga MASR Shënim: <i>Te dërgohet në ASCAL suplementi i perditësuar pasi 12.1 flet per program MPSHKA me tre semestra.</i> [dok DVV Evidenca Nr.6– Rregullorja NjKTI, neni 63], [dok DVV Evidenca Nr.12 –Modelii Diplomes dhe i Suplementit te Diplomes]			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas RVB, Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në rregulloren e tij ka përcaktuar se Provimet duhet të ruhen në sekretarinë mësimore sipas afatit të përcaktuar nga Rregullorja për arkivimin e dokumentacionit në UAMD. dhe pas korrigjimit dhe hartimit të procesverbalit, provimet mbyllen në një zarf dorëzohen në sekretarinë mësimore sipas procedurës së përcaktuar dhe mbahen në ruajtje sipas afateve të përcaktuara në rregulloren “Për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit te brëndshëm” Sipas RVB dhe Vizitës në Institucion, Sekretaria dhe Kryesekretaria mbajnë dhe krijojnë baza të dhënash me të dhënat e studentëve që regjistrohen në programin e studimit, me rezultatet e tyre gjatë kohës së studimit. Sekretaria paraqiti informacione për studentët e kërkuar gjatë vizitës në institucion. [dok DVV Evidenca Nr.6– Rregullorja NjKTI, Neni 53 pika 15 dhe neni 54, pika i] [Vizita në Institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>UAMD bazuar edhe në nenin 24 në Statut ka në funksion Zyrën e Burimeve Njerëzore e njohur si Njësi Ndihmëse Qëndrore Administrative. Kjo zyrë mban në mënyrë të rregullt të gjithë dosjet e personelit akademik me kohë të plotë, ndihmëse dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore funksionon mbi bazën e një Rregullore të Veçantë si dhe bazuar në Statut dhe në Rregulloren e UAMD-së. Kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në Fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik dhe personelit ndihmës akademik. Grupi i vlerësimit kreu edhe një vizite në këtë zyrë dhe verifikoi sistemin e mbajtjes së të dhënave dhe kontrolloi dosje të stafit akademik me kohë të plotë të anagazhuar në këtë program. Dosjet u gjetën në përputhje me Rregulloren e vetë Institucionit [DVV shënimet për vizitën në Zyrën e Burimeve Njerëzore]. [DVV Rregullore e UAMD, nenin 103 dhe 104].</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka të përcaktuar qartë në Statut dhe në Rregullore procedurat për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Njesia Bazë në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore ndjek me përpikmeri zbatimin e kriterëve për këto procedura rekrutimi duke siguruar zbatimin me transparencë dhe besueshmëri të plotë. Përzgjedhja e personelit akademik me kohë të plote bëhet me konkurrin në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njësia bazë e shkencave kompjuterike, bazuar në analizën e nevojave të tyre, përcakton kriteret specifike për vendet e punës të cilat miratohen nga Rektori. Shpallja e njoftimit për vendet e lira të punës, në forme të shkruar dhe elektronike bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Aplikimet pranohen vetëm me poste dhe postimi bëhet brenda afateve të parashikuara në njoftim. Shyrtimi i dosjeve fillon jo më shpejt se dhjetë ditë nga përfundimi i afatit të parashikuar. Drejtuesi i Njesisë Bazë së Teknologjisë dhe Informacionit në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore krijon edhe komisionin <i>ad hoc</i> i cili përbehet nga 5 (pese) anëtare, nga të cilët jo më pak se tre janë përfaqësues të njësisë bazë. Rektori dhe Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit përfaqësohen në Komision respektivisht nga një anëtar të miratuar nga ata vetë. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme që janë vlerësimi i dosjeve dhe intervistave. Vlerësimi i dosjeve zë një peshe 70% dhe vlerësimi i intervistës 30%.</p> <p>Lidhja e kontratës së punës me kandidatin fitues bëhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore e cila administron dosjen e kandidatit dhe bën edhe një përditësim të tij në mënyrë periodike (çdo vit). Vizita në zyrën e Burimeve Njerëzore evidentoi zbatimin e procedurës dhe përmbajtjen e kontratave të punës duke e gjeur atë në përputhje me kriteret dhe aktet ligjore në fuqi.</p>

	<p>Në këtë program studimi GVJ konstaton edhe angazhimin e një stafi akademik me kohë të pjesshme deri në vitin akademik 2018-2019. Per vitin akademik 2019-2020 ngarkesa është përbulluar nga staf PAE në Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Kryesisht është synuar rekrutimi i një stafi i cili mbart eksperiencë për fushën akademike dhe në veçanti të moduleve që mbulon.</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e nevojave të Njesisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit dhe procedura e rekrutimit të tyre zhvillohet në fillim të vitit akademik. Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e nenit 46 të specifikuar në Statut të UAMD –së dhe në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Kriteria specifike vendosen për përzgjedhjen e stafit akademik me kohë të pjesshme në përshtatshmëri me modulën që synohet të mbulohet. [dok.nr 1 –Statut i UAMD; dok.5- Rregullore UAMD; dok. nr.6 – Rregullore FIT; dok.nr 18 – Të dhëna tabulare për stafin; dok. nr.19- Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore]</p>			
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit harton procedura dhe kriteret specifike për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Këto kriteret konsistojnë në eksperiencën e stafit akademik në përputhje me modulën që kërkohet të mbulojë, aftësimin në grada shkencore dhe arritjet akademike në fushën e kërkimit shkencor, përvojën në mësimdhënie etj. Vendosja e kriterëve specifike bëhet në akordancë me kriteret për rekrutim të percaktuara qartë tek aktet ligjore në fuqi dhe në Statut të UAMD-së.</p> <p>Bazuar në nenin 47 në Statut, Njësia Bazë e Shkencave Kompjuterikeka të drejtë të kërkojë punësimin me kontratë për periudha të shkurtra kohe, studiues dhe personalitete të shkencës. Personeli i ftuar rekrutohet në përputhje me kriteret specifike të dhëna nga njësia bazë dhe të miratuara nga Rektori. GVJ nuk evidentoi raste për Lektore të ftuar për këtë program studimi. [dok.nr 1 –Statut i UAMD; dok.5- Rregullore UAMD; dok. nr.6 – Rregullore FIT; dok.nr 18 – Të dhëna tabulare për stafin; dok. nr.19- Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore]</p>			
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Statut përkatesisht neni 45 dhe 46 dhe në Rregulloren e UAMD-së, GVJ evidenton zbatimin e procedurave të qarta dhe transparente në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme nga Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore. Kriteret specifike të vendosura nga Njësia Baze sipas nevojave të identifikuara janë në përshtatshmëri me vete programin e studimit dhe modulet pjesë përbërëse e tij. [DVV Rregullore e UAMD-së, neni 103, 104 dhe 105]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UAMD zoteron ambjente të përshtatshme për të garantuar zhvillimin e programit të studimit MPShKA. Programi i studimit zhvillohet në ambjentet e ndertesës të pozicionuar në Zonen e Vollgës në Durrës. UAMD zotëron ambjente studimi edhe në ndërtesën nr.2 të pozicionuar në zonën e ish – kenetës Durres (godinë e re). Ambjentet e studimit janë në përputhje me standartet për të garantuar një cilësi në mësimdhënie. Godina është e mirëmbajtur mirë dhe e pajisur me të gjithëmjetet didaktike për një funksionim të studimit. Personeli akademik me kohë të plotë, të pjesshme, dhe stafi ndihmes akademik janë të pajisur me zyrat e tyre dhe tësiguruar me të gjithë mjetet që u garantojnë atyre lehtësim në procesin e mësimdhënies. Klasat janë të ndriçuara siç duhet në zbatim të standarteve për një ndriçim natyral dhe të qartë. Infrastruktura është e duhur dhe bashkëkohore. Ndërtesa garanton një akses edhe për studentët me aftësi të kufizuar (rampa në shkalle dhe ashensorë) në të gjithë katet e saj. Ambjentet e mësimdhënies zhvillohen në katin e parë dhe të dytë ndërsa zyrat për stafin akademik me kohë të plotë dhe të drejtuesve të njëjësive baze të Inxhnierisë Kompjuterike janë të pozicionuar në katin e tretë. Klasat për seminare, leksione dhe labororët janë të pajisur me mjete audiovizive dhe mbulojnë një kapacitet që tejkalon numrin e studentëve të regjistruar për këtë program studimi. [DVV evidence – Infrastruktura; evidence – vizite ne ambjentet mesimore]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në bashkëpunim edhe me njësinë bazë të Inxhnierisë Kompjuterike inkurajon kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Pjesëmarrja në konferenca kombëtare që Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit organizon për vit, pjesëmarrja në konferenca në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar inkurajohen dhe mbështeten për stafin akademik me kohë të plotë. Në lidhje me stafin akademik me kohë të pjesshme monitorohet progresi i tyre dhe të dhënat rifreskohen dhe administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore. Angazhimi i stafit akademik në projektet kërkimore shkencore është e theksuar edhe në Statut dhe në Regulloren e UAMD dhe vlerësimi i tyre bëhet në analizat vjetore të njëjësive bazë të Shkencave Kompjuterike. [dok. nr.31 Analiza vjetore; dok. nr. 30. Raporti Shkencor; dok. 30.2 – të dhëna për kualifikim të stafit]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Për këtë program studimi nuk evidentojmë zbatimin e programeve specifike por metodat inovative të mësimdhënies janë një synim i vazhdueshëm. Në mbledhjen me stafin akademik evidentojmë një punë të vazhdueshëm të tyre në lidhje me përmirësimin e kurrikulës në tërësi dhe të moduleve në veçanti. Përmirësimi i vazhdueshëm bazohet në progresin aktual në fushën e shkencave kompjuterike dhe të teknologjisë së informacionit. Ky progress transmetohet në auditor përmes formave të mësimdhënies në mënyrë që ajo të përcillet qartë dhe të jetë e aplikueshme tek studentët. Shembuj u sollen në lidhje me përmirësimet e bëra në module nga takimi me stafin akademik. Metodatat inovative janë përmirësuar në vite edhe me krijimin e mjediseve laboratorike duke e</p>

	<p>bërë më praktike përmbajtjen e modulit dhe më të aplikueshme tek studentët.</p> <p>Gjithashtu stafi akademik është trajnuar në kuadër të projekteve të financuara nga Erasmus+, si më poshtë:</p> <p>Trajnim i stafit në kuadër të projektit ITG4AU, nga partnerët spanjoll. Trajnimi ka të bëjë me organizimin dhe menaxhimin e njohurive në funksion të qeverisjes dhe mirëmenaxhimit të burimeve IT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Management meeting, ITG4AU (Universita de Baleares, Palma, Spain); • Best Practices Development (SRH-Hoghschule, Berlin, Germany); • Maturity model, ITG (Universita de Almeria, Almeria, Spain) • Klemen Pecnik. 'E ardhmja dhe e tashmja e teknologjive multimediale' (i ftuar nga Universiteti i Ljublanës); <p>[dok. 28- Raporti i fundit periodik analitik i perfituesve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit]. [DVV takim – vizitë].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Shkencave Kompjuterike janë përgjegjëse për ndjekjen dhe administrimin e të dhënave të stafit akademik në lidhje me progresin tyre përmes pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo zyrë në bashkëpunim me njësinë bazë mundëson përmbushjen e nevojave për personel akademik përmes zbatimit me përpikmëri në kohën e duhur të procedurave të rekrutimit dhe garantimin e një transparence të plotë. [dok.nr 1 – Statut i UAMD; dok.5- Rregullore UAMD; dok. nr.6 – Rregullore FIT; dok.nr 18 – Të dhëna tabulare për stafin; dok. nr.19- Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UAMD zotëron dy godina për të garantuar zhvillimin e programeve të studimit. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit është i pozicionuar në godinën nr. 1 por në varësi të nevojave dhe kërkesave ka kapacitet për zhvillimin e mësimdhënies në godinën nr.2. Për zhvillimin e procesit mësimor janë vënë në dispozicion ambiente të duhura për leksione, seminare dhe orë laboratorike. Në këtë godinë është edhe salla e konferencës e cila mundëson edhe zhvillimin e leksioneve të hapura kryesisht me lektorë të ftuar nga kompanitë e biznesit. Klasat dhe laboratorët kanë një kapacitet mbi 35 studentë dhe kjo garanton përmbushjen e plotë të këtij standarti (duke konsideruar që për vitin</p>

	<p>akademik 2018 – 2019 ky numër është 31).</p> <p>[33. Te dhena per infrastrukturen UAMD FORMULARI KAPACITETEVE 2018-2019], [34. Lista e librave fizike që ndodhen në bibliotekën 1 për FTI], [35. Udhezues per perdorimin e struktures TI-manuaL AULA], [35.1 kontrata e Sistemi AULA], [36. Te dhena nga fq zyrtare - Calls published in the official website of Aleksandër Moisiu Durrës], [37. raporti monitorimit financiar 12 mujor shtator 2018- gusht 2019 per Bordin], [38. tabela per kostot e programeve MPSHKA], 39. Plani i marketingut te MPSHKA]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe njësia bazë e shkencave kompjuterike garantojnë një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e procesit të mësimdhënies për këtë program studimi. Mësimdhënia zhvillohet në fundjave dhe të gjithë mjediset janë vënë në dispozicion të plotë. Klasat kanë një kapacitet që tejkalon numrin e studentëve për këtë program studimi.</p> <p>Bashkëpunimet me biznesin, kompanitë e programimit etj, kanë qenë të vazhdueshme, që nga momenti i hapjes së programit, por janë konkretizuar me marrëveshje institucionale këto vitet e fundit. Aktualisht fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Crystal System, e cila ka qënë gjithnjë e pranishme me suportin e saj, në aktivitetin mësimor-kërkimor-shkencor të stafit dhe të studentëve. Si rezultati këtij bashkëpunimi kjo kompani ka ofruar për UAMD investimin e 5 laboratorëve, nga te cilët 3 janë në fakultetin Teknologji Informacioni. Programi i studimit MPSHKA, ka në përdorim 2 nga këta laboratore.</p> <p>Në këtë program studimi janë vënë në dispozicion 2 laboratorë të pozicionuar në katin e parë dhe të dytë të godinës. Secili laborator ka 30 PC, një projektor dhe SW të duhur në mbështetje të përmbajtjes së lëndës. Në takimin me studentët u theksua vënia në dispozicion e përmbajtjes se ores se mesimit e cila per kete program studimi duhet përmendur që është e kombinuar midis orës teorike dhe praktike. Çdo temë trajtohet në teori dhe më pas kalohet në praktikën laboratorike. Krijimi i dy laboratorëve të rinj u konsiderua e rëndësishme jo vetëm nga stafi akademik por edhe nga studentët të cilët në opinionet e tyre u shprehen për orët laboratorike si shumë të dobishme për përfitimn e përvojës. Mungesa e këtyre laboratorëve gjatë kohës së studimit në nivelin Bachelor konsiderohej nga studentët si një dobësi e cila në këtë program studimi është përmirësuar dhe ndikon fuqimisht në gërshetimin e teorisë me praktikën.</p> <p>Tashmë Njësia Bazë synon në hapjen e një laboratorit të ri i cili do të mundësojë që një pjesë e studentëve të zhvillojnë edhe praktikën profesionale brenda ambjenteve laboratorike.</p> <p>[vizitë: Inspektimi i infrastrukturës së Institucionit; dok. 28 Raporti periodic analitik]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të</p>	<p>Njësia Bazë e Tenologjisë së Informacionit zotëron 5 laboratorë ku dy prej tyre janë në dispozicion për këtë program studimi. Evidentuar ndërthurjen dhe shfrytëzimin edhe të ambjenteve të tjera laboratorike nga studentë të këtij program studimi.</p>

studimit që ofron.	[vizitë: Inspektimi i infrastrukturës së Institucionit; dok. 28 Raporti periodic analitik]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	UAMD zotëron dy godina të pajisur me ambjente të duhura (klasa dhe laboratorë) për të garantuar mësimdhënien. Për këtë program studimi janë vënë në dispozicion të gjithë ambjentet mësimore dhe ndihmëse për të garantuar cilësinë në mësimdhënie. Departamenti i Shkencave Kompjuterike nuk shfrytëzon ambjente të institucioneve të tjera, por bashkëpunon me kompani biznesi për të përmirësuar infrastrukturën mësimore sidomos në drejtim të përmirësimit të kushteve laboratorike dhe didaktike. [vizitë: Inspektimi i infrastrukturës së Institucionit; dok. 28 Raporti periodic analitik]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>UAMD zotëron bibliotekë e cila kategorizohet si Bibliotekë Universitare dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të veçantë dhe në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në Statut për njësitë ndihmëse qëndrore</p> <p>UAMD ka në secilën godinë të saj bibliotekën e cila është e vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. Biblioteka funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar dhe aprovuar nga institucioni. Biblioteka përbëhet nga tre sektore si vijon më poshtë:</p> <p>1.Sektori i Informatikës dhe i Teknologjive të Reja në Shërbim të BUAMD</p> <p>Sektori i Informatikës mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore në bashkëpunim me Drejtorin e Bibliotekës. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, të dy sistemeve (sistemin e integruar të bibliotekës me programin “KOHA” dhe sistemin e dixhitalizimit “Dspace” (në process instalimi) si dhe funksionimin të Hardware dhe Software të të gjithë kompjuterave që disponon biblioteka 1 dhe 2.</p> <p>Në Nëntor 2014 me shfrytëzimin e sistemeve me baze "kod ne burim të hapur", është lançuar sistemi i Arkives Dixhitale të Bibliotekës Shkencore, duke mundësuar arkivimin dhe ruajtjen në format elektronik të fondit të Bibliotekës, si edhe servirjen e këtij fondi nëpërmjet portalit ëeb. Kliko për të aksesuar: katalogonline.uamd.edu.al</p> <p>Kjo baze të dhënash përmban deri tani 10.000 rekorde.</p> <p>Biblioteka ka instaluar falas një sistem të integruar bibliotekar “KOHA”. Me shfrytëzimin e sistemeve me baze "kod në burim të hapur", është</p>

	<p>lançar Katalogu Online, si modul i sistemit të integruar për menaxhimin e fondit të Bibliotekës Shkencore.</p> <p>Njëkohësisht, biblioteka është pjesë e projektit Cobiss, financuar nga qeveria sllovene. Përfitimet janë përfshirja e bibliotekës tonë në Bibliotekën Virtuale të shqipërisë, trajnimi falas i personelit të bibliotekës për një kohë të pacaktuar. Aktualisht sistemi përmban rreth 1700 rekorde të hedhura.</p> <p>2.Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve</p> <p>Koleksionet e bibliotekës pasurohen nëpërmjet, blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit midis bibliotekave.</p> <p>Politika e pasurimit të BUAMD është drejtuar kryesisht për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. 80% e literatures i përket 10 viteve të fundit si dhe shtëpive botuese më cilësore botërore. Duke pasur parasysh dhe natyrën e BUAMD, ajo përpiqet të sigurojë botime nga të gjitha fushat e shkencës për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkesave të përdoruesve të saj në rritje.</p> <p>3.Sektori i Shërbimit dhe i Informacionit:</p> <p>Biblioteka Shkencore e UAMD qarkullon rreth 20.000 njësi bibliotekare në vit, ndërkohë që numri i frekuentuesve është rreth 2000 përdorues në sallën e leximit me fonde të hapura dhe të mbyllura.</p> <p>[DVV evidence nr.2-Statut neni 23; evidence nr.44- Rregullore e bibliotekës; evidencë nr. 34 Lista e librave fizikë; evidence nr. 35-Udhëzues I përdorimit të manualit AULA; evidence nr. 45-Biblioteka online; dok. shtese-marreveshje bashkëpunimi me Rosetta stone + Biblioteka.]</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bibliotekat në të dy godinat garantojnë një literaturë fizike dhe ndihmëse për stafin akademik dhe studentët. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj (kryesisht për këtë program studimi dominon gjuha angleze). GVJ bëri një vizitë në bibliotekën në godinën nr.1 ku zhvillohet edhe ky program studimi. U evidentua zbatimi I rregullores për funksionim e saj. Në raftet e caktuara u panë tekste mësimore për këtë program studimi, dispenca leksionesh dhe tekste ndihmëse. Numri i kopjeve për tekste në gjuhën shqipe varion 2-5 ndërsa për tekste në gjuhë të huaj është 1-2. Krahas librit fizik biblioteka vë në dispozicion edhe librin elektronik dhe shumë revista shkencore (kryesisht në sistemin on-line) të cilat i gjetëm të përditësuara. Aktualisht biblioteka zotëron 35 libra në gjuhën angleze dhe në shqip për këtë program studimi nga 142 në total. [DVV evidencë nr.44- Rregullore e bibliotekës] DVV evidencë nr. 34- Lista e librave fizike që ndodhen në bibliotekë; dok shtese -Konfirmimi për marrjen e botimeve nga BSH. ; dok shtese- Faqja e databazës së Bibliotekës UAMD; dok shtese - Linku i Databases së Bibliotekës UAMD]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Bibliotekës përkatësisht neni 3 të saj dhe në vetë misionin synohet në sigurimin e një shërbimi falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës. Në bazë të veprimtarisë së saj qëndron një akses i barabartë për të gjithë hallkat pjesë përbërëse e sistemit arsimor në këtë institucion. Çdo student, pedagog dhe staf</p>

	ndihmës akademik ka një anëtarisim falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me një librezë anëtarësie. Ai ka të drejtën të përdorë kompjuterat e sallave të bibliotekave për navigimin në burimet elektronike ose përdorimin e katalogut elektronik [DVV dok 3 shtesë- application form; evidencë nr. 45-Biblioteka online].			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibliotekat kanë në sallat e tyre një sistem kompjuterik që mundëson çdo anëtar të saj të përftojë informacion në kohe – reale. Biblioteka është e pajisur me program të duhur kompjuterik për mirëmbajtjen dhe administrimin e të dhënave dhe me programe të duhura që aftësojnë çdo anëtar të navigojë on-line. Në kompjuterat e saj janë instaluar programe specifike për disiplinat e studimit, ku studentët studiojnë dhe bëjnë detyrat e tyre. [DVV evidence nr. 35- Udhëzues I përdorimit të manualit AULA; evidence nr. 45-Biblioteka online; dok shtese- Faqja e databazës së Bibliotekës UAMD; dok.shtese - Linku i Databases së Bibliotekës UAMD;]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Biblioteka pasurohet me libra fizike mbi bazën e kërkesave të ardhura nga njësitë baze të çdo Fakulteti. Takimi me stafin akademik theksoi nevojën për literaturë të re dhe procedurat për përftimin e tyre. Mbi bazën e kërkesave dhe në zbatim të procedurave të përcaktuara qartë në Rregulloren e UAMD-së dhe në rregulloren e saj bëhet edhe pasurimi me libra fizike. Në lidhje me sistemin on-line, përpjekjet janë të vazhdueshme. Për këtë bazuar në procedurën për shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur” është instaluar falas edhe katalogu Online i Integruar. [DVV evidencë nr. 34 Lista e librave fizikë; vizitë në bibliotekë]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka vihet në dispozicion të studentit gjatë javës dhe në fundjave të saj. Orarin e saj e gjetëm të shpallur në ambjentet e godinës dhe në ëëbsite të UAMD. Salla është komode dhe është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00. [DVV evidence nr.44- Rregullore e bibliotekës; vizitë në bibliotekë]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në	UAMD administrojnë të dhënat dhe informacionin në lidhje me studentët të cilët janë pjesë e programit të studimit. Ndonëse në Statut në nenin 23 të saj nuk është vendosur Sekretaria Mësimore si njësi ndihmëse qëndrore, kjo zyrë në bashkëpunim edhe me Zyrën e Burimeve Njerëzore menaxhojnë dhe administrojnë të dhënat për studentet, stafin akademik dhe personelin ndihmës akademik dhe administrativ.

<p>programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sekretaria mësimore funksionon mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të vendosura në kushtet për pranimin, regjistrimin e studentëve në programe studimit. Kjo zyrë është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve në program studimi, ofrimin e një username dhe pasëordi personal. Sekretaria mësimore në bashkëpunim edhe me Njësinë Bazë të Shkencave Kompjuterike administron të dhënat e studentëve, notat përkatëse të tyre duke i hedhur në regjistrat e veçantë deri në diplomimin e tyre. Vizita në këtë zyrë evidentoi zbatimin korrekt të procedurave të regjistrimit të studentëve dhe pajisjen e tyre me një numër matrikulimi, mbajtjen e notave në regjister të veçante deri në dhënien e diplomes dhe suplementit të saj. Në këtë zyrë u bënë edhe verifikime të të dhenave të 3 studentëve në formë rastësore [DVV – shënimet e viztës]. Verifikimet u bëne në numrin e matrikulimit, në hedhjen e notave në regjistrin e notave mbi bazën e proces- verbaleve të dorëzuara nga pedagogët e lëndës dhe kontrollin e dosjes personale të çdo studenti. Nga verifikimet çdo procedurë u gjet konform rregullave dhe kriterëve të percaktuara nga MASH dhe nga Rregullorja e UAMD-së.</p> <p>UAMD zotëron një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe administrit të të dhenave. Funksionimi i saj bëhet mbi bazën e rregullores së institucionit dhe ruajtjes së konfidencialitetit. Informacioni mbi të dhënat e personelit akademik, ndihmës dhe administrativ menaxhohen nga zyra të posaçme të miratuara nga Senati Akademik dhe të shprehura në Statutin e UAMD-së. Këto struktura ndihmëse qëndrore në bashkëpunim edhe me njësitë bazë menaxhojnë dhe administrojnë të dhënat dhe progresin e tyre duke i shprehur ato në formë të raporteve përkatëse periodike. [DVV-Statut, Rregullore e UAMD dhe rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit], [DVV –Statut I UAMD, neni 23].</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD zotëron një sistem i cili mundëson shpërndarje të informacionit në të gjithë hallkat pjesë përbërëse e tij. Informacioni është i hapur edhe për studentët dhe stafin akademik. Analizat e pyetsorëve, raportet periodike transmetohen në formë të duhur tek stafi akademik. Informacioni në lidhje me aktivitetet shkencore, workshop, konferenca dhe mundësi për aplikime për bursa shpallen në website dhe në stenda. Në lidhje me shpërndarjen e leksioneve dhe të informacionit për mësimdhënien shfrytëzohen edhe foldera të përbashket si Dropbox, GoogleDrive të krijuar nga vetë pedagogët për një komunikim më të mirë dhe interaktiv me studentët. Sekretaria mësimore për një akses më të shpejte me këta të fundit për këtë program studimi funksionon edhe në fundjava duke ju përgjigjur në mënyre efektive studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Zyra e Kerkimit Shkencor përmes email-it, website dhe stendave njofton për aplikime në projekte kërkimore shkencore, ndërsa Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni bën njoftime në stenda dhe përmes adresave elektronike të studenteve thirje për punësim dhe workshop mbi mënyre e plotësimi të një aplikimi dhe intervistë për punë.</p> <p>[Dok. nr.10 – Rregullore e Këshimit, Karrierës & Alumni; shënimet nga</p>

	mbledhjet			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përdor një sistem të menaxhimit të informacionit i cili ka të integruar sistemin AULA ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhënat në lidhje me vlerësimin e studentëve.</p> <p>Ky sistem nuk është vënë në funksion për studentët e programit të studimit MPShKA (zbatohet për studentët e nivelit Bachelor) por synohet në kohë shumë të shkurter të jetë instaluar.</p> <p>GVJ evidenton se nuk ka një sistem qëndror të menaxhimit të të dhënave për stafin akademik, studentët dhe personelin ndihmës dhe administrativ. Në forma të caktuara dhe në bazë të detyrave dhe misionëve, UAMD ka vënë në funksion organizma dhe struktura ndihmëse qëndrore përgjegjëse për mbledhje të informacionit, përpunimin e tij dhe vlerësimin e progresit të bërë nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Çdo informacion që nuk cënon konfidencialitetin është i publikuar në website të UAMD-së si edhe në rrjetet sociale zyrtare të Institucionit si www.uamd.edu.al; facebook: Universiteti “Aleksander Moisiu”; instangram: uamdoofficial; facebook: Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;</p> <p>[DVV evidence nr. 35- Udhëzues I përdorimit të manualit AULA; evidence nr. 45-Biblioteka online, takim me studentët, takim me stafin akademik]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAMD ka vënë në funksion të menaxhimit të fondeve financiare struktura si Bordi i Administrimit, Administratori i Përgjithshëm dhe Administratore në çdo Fakultet të cilët funksionojnë dhe kryejnë detyrat e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Statut dhe në Rregullore të UAMD-së dhe të Rregullores të çdo Fakulteti në veçanti. Si njësi ndihmëse qëndrore është e ngritur edhe Drejtoria e Financës e cila harton raportin financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit. Ky raport hartohet në bashkëpunim me njësinë bazë të Teknologjisë dhe Informacionit.</p> <p>[DVV evidencë nr.38 –Tabela e kostove te MPaShK; dok.nr.37 – Raporti i monitorimit financiar 12 muhor shtator 2018 – gusht 2019]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit,</p>	<p>Institucioni I siguron burimet e financimit përmes financimit nga buxheti I shtetit, financim nga tarifat e studentëve si edhe financim nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë;</p>

<p>shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit përfshin të ardhurat e pritshme dhe shpenzimet operative në lidhje me burimet njerëzore, kostot për mirëmbajtjen e sallave nr 1 dhe nr 2 të laboratorëve. Në tabelën e përlllogaritjes së kostove të dorezuar nga institucioni evidentojmë se kemi një rritje të angazhimit të stafit akademik me gradën “Doktor i Shkencave” duke u rritur edhe totali i oreve të zhvilluar nga kjo kategori në krahasim me periudhën 2015-2016. Evidenton një rënie të numrit të orëve për kategorinë me gradën “Profesor” përkatësisht:</p> <p style="text-align: center;">2015-2016: 48 orë 2016-2017: 864 orë 2017-2018:432 orë 2018-2019: 192 orë</p> <p>GVJ konstaton që shpenzimet për materiale didaktike, për mirëmbajtje laborator nr.1 dhe nr,2, shpenzimet për promovimin e programit të studimit janë të pandryshueshme në periudhat financiare të marra në studim. GVJ konstaton se këto shpenzime duhet të jenë të luhatshme në periudha të ndryshme financiare duke shprehur qartë dhe në mënyrë reale edhe situatën përkatëse financiare. GVJ konstaton se në tabelën e kostove Institucioni nuk ka një zë të veçantë për librat.</p> <p>GVJ evidenton një rënie të totalit të shpenzimeve vjetore dhe po ashtu edhe kosto për një kredit.</p> <p>[DVV evidencë nr.38 –Tabela e kostove te MPaShK; dok.nr.37 – Raporti i monitorimit financiar 12 mujor shtator 2018 – gusht 2019]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UAMD i nënshtrohet një sistem auditimi të brendshëm dhe të jashtëm.Institucioni harton edhe nje raport financiar, i cili detajon të ardhurat nga burimet financiare dhe shpenzimet.</p> <p>[DVV evidencë nr.38 –Tabela e kostove te MPaShK; dok.nr.37 – Raporti i monitorimit financiar 12 mujor shtator 2018 – gusht 2019]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli studimi UAMD dokumenton edhe raportet financiare të tre viteve të fundit dhe bën planifikimet për ndërhyrje të posaçme.</p> <p>[DVV evidencë nr.38 –Tabela e kostove te MPaShK; dok.nr.37 – Raporti i monitorimit financiar 12 mujor shtator 2018 – gusht 2019]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të</p>	<p>UAMD dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmeri financiare.</p> <p>GVJ konstaton nga shqyrtimi I dokumentacionit se pjesa me e madhe e te ardhurave (ose 95.5% e te ardhurave totale) arketohet nga tarifat e</p>

<p>programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>shkollimit, 2.1% e të ardhurave arketohet nga tarifat e regjistrimit, 3.5% e të ardhurave arketohet nga tarifa të tjera (trajnime, pjesmrraje në konferenca, pajisje me programe studimi, tarifa diplomimi etj). Të ardhurat nga tarifat e shkollimit janë realizuar në masën 53% nga tarifat e shkollimit të cilit të parë dhe 47% nga tarifat e shkollimit të ciklit të dytë.</p> <p>Në krahasim me vitin akademik 2017-2018 ka një rënie e të ardhurave të realizuara gjatë vitit akademik 2018-2019 me 23 904 167 leke më pak. GVJ konstaton se shifrat mësipër janë për UAMD si institucion dhe jo për programin në vecanti.</p> <p>[DVV evidencë nr.38 –Tabela e kostove të MPaShK; dok.nr.37 – Raporti i monitorimit financiar 12 muor shtator 2018 – gusht 2019]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UAMD harton politika dhe procedura që mbështesin përthithjen e studentëve për këtë program studimi. UAMD ndjek edhe të gjithë aktet ligjore në fuqi në lidhje me kushtet e pranimit, regjistrimit, mobilitetit dhe transferimit të studentëve. Neni 63 “Programet e ciklit të dytë të studimeve”, neni 64 “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”, neni 72 “Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies”, neni 74 “Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave”, neni 75 “Kohëzgjatja e studimeve”, neni 76 “Lëshimi i diplomave, çertifikatave dhe suplementi i diplomës”, të theksuara në Statut janë shprehje e vendosjes së një kuadri ligjor të qartë në lidhje me studentët. Kriteret e theksuara në Statut i gjejmë të reflektuara edhe në Rregulloren e UAMD-së, në Rregulloren e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit [DVV evidencë nr 2 – Statuti i UAMD-së; evidencë nr.3 Plani Strategjik 2019 – 2022; evidencë nr. 5 - Rregullore e UAMD-së; evidencë nr. 6- Rregullore e FIT; evidencë nr.7 - Rregullore e Programit të Studimit;</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e</p>	<p>UAMD ndjek politika të qartë në lidhje me pranimin e studentëve. Këto procedura janë në akordancë edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi dhe të kërkuara edhe nga MASH. Procedurat e pranimit të studenteve i gjejmë të shprehur edhe në Rregulloren e Programit të</p>

<p>programit të studimit.</p>	<p>Studimit. Ato janë të pasqyruar në website të UAMD-së, në fletëpalosje etj. Departamenti Shkencave Kompjuterike ka hartuar edhe një formular aplikimi e cila përmiresohet çdo vit dhe jep një informacion të qartë në lidhje me përmbajtjen e programit, stafin akademik të angazhuar dhe kushte e pranimit të studenteve [DVV evidencë nr. 11- Dosja e plotë e aplikimit].</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve janë zbatuar me rigorizitet nga njësia bazë për këtë program studimi. Kriteret e pranimit të theksuara në Statut dhe në Rregulloren e Programit të Studimit janë të pasqyruar edhe në dosjen e aplikimit i cili përmiresohet çdo vit nga Njësia Bazë e Inxhinierisë Kompjuterike. Në kriteret e pranimit theksohet konsiderimi i një note mesatare mbi 7, në diploma të sistemit të vjetër apo në Diplomë të nivelit të I-rë. Ky kriter u verifikua edhe në vizitën e bërë në Sekretarinë mësimore ku ne shqyrtimin e tre dosjeve të studenteve përkatesisht për vitet akademike 2014-2015, 2016-2017 dhe 2017-2018 gjen zbatimin e kriterit të mesatares në kushtet e pranimit të studentëve.</p> <p>Njësia bazë zbaton edhe kushte të veçanta pranimi për studentet të cilët nuk vijnë nga një i njëjti institucion i Arsimit të Lartë. Si kriter është vendosur njohja e njohurive formuese për student të cilët janë diplomuar në Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni”, “Sisteme Informacioni”, “Matematikë Informacioni” dhe “Informatikë – English”.</p> <p>Brenda këtij spektri pranohen edhe student me diploma Bachelor në “Informatikë”, “Inxhinieri Informatike”, “Teknologji Informacioni dhe komunikimi”, “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, “Teknologji Informacioni” dhe “Informatikë Ekonomike”. Nga njësia baze kërkohet në kriter pranimi plotësimi i njohurive formuese për student të cilët zotërojnë diploma Bachelor në “Matematikë – Fizikë” me 24 kredite, Diplomë Bachelor në “Multimedia dhe television dixhital” me 18 kredite, dhe diploma Bachelor në “Shkenca Ekonomike” me 18 kredite.</p> <p>Për studentët të cilët vijnë në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe që zotërojnë diploma në “Inxhinieri Kompjuterike”, “Inxhinieri Telekomunikacioni”, “Inxhinieri Elektrike”, “Inxhinieri Gjeo-Informatike” dhe “Matematike” është vendosur plotësimi i 24 krediteve të njohurive formuese për pranimin e këtyre studentëve në këtë program studimi. Në formularin e aplikimit GVJ konstaton edhe lëndet përkatëse të shoqëruar edhe me kreditet që konsiderohen të detyrueshëm për tu plotësuar nga studentët sipas diplomës në fushat e lartëpërmendura më sipër. Kriteret e vlerësimit të studentëve janë të pasqyruar në Rregullore e FTI-së, në Rregulloren e Programit të Studimit. Studentët marrin informacion nga Sekretaria Mësimore, nga pedagogët e lëndës, nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe nga struktura si NJSBC, Zyra e Komunikimit, Karrierës & Alumni në lidhje me kushtet e pranimit, transferimit dhe vlerësimit të tyre. [DVV evidencë nr.11 – dosja e plotë e aplikimit]. [Rregulloren e Programit të Studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe</p>	<p>Njësia bazë e shkencave kompjuterike çdo vit harton dosjen e aplikimit</p>

<p>publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>duke përmiresuar edhe kushtet e pranimit të studentëve. Kushtet e pranimit miratohen nga Senati Akademik pas propozimeve të paraqitura nga NJB dhe të miratuar nga Dekanati i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Kuotat dhe kriteret e pranimit propozohen jo më vonë se data 30 Nëntor dhe miratohen në Dekanat jo më vonë se data 15 Dhjetor, afat ky në përputhje edhe me aktet ligjore në fuqi. Përzgjedhja e studentëve është në Strategjine e UAMD-së dhe në vetë Strategjinë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Një nga synimet vlen të përmendet edhe ndërkombetarizimi i studentëve dhe kjo shoqërohet edhe me përmirësime në kushtet e pranimit të tyre në pershtatje me diplomat Bachelor që ata zoterojnë [DVV evidence nr.4 Plani Strategjik 2019-2022];</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzohet publikon dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Fakultetit i Teknologjisë së Informacionit dhe NJB ndjekin një politikë sensibilizimi dhe informimi në lidhje me këtë program studimi. Një punë përgatitore bëhet me studentët e vitit të tretë të nivelit Bachelor, ku këta të fundit informohen në lidhje me përmbajtjen, synimet dhe mundësitë e punësimit nga ndjekja e studimeve në këtë program studimi Informimi bëhet edhe përmes rrjeteve sociale si facebook, istagram, dhe në website www.uamd.edu.al;</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, Njësia Bazë e Shkencave Kompjuterike, stafi akademik dhe sekretaria mësimore udhëzojnë studentët në lidhje me procedurat e regjistrimit, kushte e pranimit, plotësimin e formularëve të regjistrimit, pagesat përkatëse që duhet të kryejnë. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve dhe pasqyrimin e listës së tyre për aprovim në strukturat përkatëse të MASH-it dhe dhënien e numrit të matikulimit për çdo student të regjistruar. [DVV], [Shënimet nga takimi me studentët, [Takimet në sekretarinë mësimore].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Sekretaria mësimore bazuar edhe në detyrat e përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit është përgjegjëse për përgatitjen e regjistrave mësimore dhe mirë sministrimin e tyre. Ajo ndër detyrat e saj ka edhe informimin e studentëve në lidhje me vlerësimet e kryera. Progresi i studentëve ndiqet edhe nga stafi i pedagogëve gjatë vitit akademik.</p> <p>Në raste vështirësie në lidhje me progresin e studentëve në lëndë, ofrohen orare tutoriati përkatësisht 9.00-12.00 gjatë javes [DVV evidence: Shënimet nga takimi me stafin akademik].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të</p>	<p>Çdo student në këtë program studimi ka të drejtën të bëjë njohjen dhe ekuivalentimin e lëndëve. Kjo e drejtë sanksionohet në Statut, në Rregulloren e FIT, në Rregulloren e Programit të Studimit. Përmes një</p>

<p>kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>kërkese me shkrim sekretaria mësimore informon studentin për procedurën e ekuivalentimit dhe transferimit të lëndëve. Bazuar edhe në nenin 36 në Rregulloren e Programit të Studimit lejohet transferimi brenda të njëjtit cikël studimi për fushë studimi të njëjta ose të përafërta dhe kjo realizohet vetëm në fillim të vitit akademik. Periudha e studimit dhe të drejtat e detyrimeve të programit të studimit të kryera në institucione të tjera të vendit ose të huaja mund të njihen dhe të njehsohen nga MASH përgjegjëse për arsimin nga pikëpamja e të drejtës për të vazhduar arsimin në një program të njëjtë ose të ngjashëm. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga studenti që transferohet e ka komisioni <i>ad hoc</i> i ngritur nga Njësia e Dekanatit të FIT. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të aplikuara. Aktualisht nga të dhënat e marra në sekretari në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar për periudhën 2016 – 2019 nuk konstatuam raste të transferimit të studentëve. [DVV evidencë nr.2 – Statut I UAMD, evidencë nr. 5- Rregullore e UAMD, evidencë nr.6- Rregullore e FIT, evidencë nr. 7 – Rregullore e programit të studimit]. [DVV evidence – Tabela e numrit të studenteve nga sekretaria mesimore].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UAMD përmes sekretarisë mësimore dhe stafit akademik informon studentët në lidhje me progresin dhe vlerësimin e tyre. Vlerësimi i studentit për këtë program studimi bazohet mbi kriteret e vendosura në nenin 22 në Rregulloren e Programit të studimit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve përcaktohen në programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve. Vlerësimi në një lëndë bëhet :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Me provim me shkrim, me gojë ose të kombinuar; 2. Me detyra kursi ose projekte kursi; 3. I bazuar në kombinime formash; <p>Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave (5 deri në 10). Në të gjithë format e provimit përdoret sistemi i vlerësimit me 1000 pikë, ku vlera përkatëse është konvertuar në note sipas kriterëve të dhëna në këtë Rregullore.</p> <p>Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur edhe në syllabuse. Nga takimi me studentët u konstatua informi i tyre në lidhje me provimet e pjesshme, detyrën e kursit dhe provimin final. Për procedurë ankimi, studenti informohet nga Koordinatorin e Programit të Studimit dhe nga Sekretaria Mësimore. Afat kohor të ankesës të specifikuar në Rregulloren e FIT dhe në Rregulloren e Programit ishin të njohur nga studentet. Vlerësimet e provimeve dërgohen nga stafi akademik me email. Për provimet e pjesshme, u jepet mundësia e trajtimit të zgjidhjes së tezës së provimit. Në nenin 23 në Rregulloren e Programit të studimit janë pasqyruar qartë edhe kriteret për mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit. Takimi me studentët konstatoi informimin e tyre në lidhje me periudhën për marrjen e rezultatit të provimit dhe të drejtën për ankimim bazuar në nenin 28 në Rregulloren e Programit të Studimit..</p>

	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve nga ana e stafit akademik është e sanksionuar në nenin 24 dhe 25 të Rregullores së Programit të studimit. Nga takimi në Sekretarinë Mësimore u bënë verifikime të process-verbaleve të plotësuar nga stafi akademik dhe pasqyrimi i qartë i tyre në rregjistrin e notave. GVJ konstatoi se process-verbale të vlerësimit të plotësuar nga pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit ishin në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara qartë në Rregullore. Personeli akademik është përgjegjës edhe për dokumentimin e vlerësimeve në sekretarinë mësimore dhe në një zarf të mbyllur edhe tezat e korrigjuara së bashku me tezat origjinale. Organizimi i provimit bëhet sipas standarteve të vendosur në Rregullore dhe zbatohet mënyra e sekretimit. [DVV evidencë nr. 7 –Rregullore e programit të studimit].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi përmes takimeve të kryera që ka një njohje të përgjegjësi për studentin në provimin përfundimtar. Këto përgjegjësi janë të përcaktuara qartë edhe në Rregulloren e Programit përkatësisht nën 19 dhe 20 i saj. Çdo student i cili ka shlyer edhe detyrimet akademike ka të drejtën të realizojë një provim të përgjithshëm formues.</p> <p>Provimi përmban pyetje nga lëndët që janë zhvilluar në këtë program studimi. Pyetjet përgatiten nga lektorët e Njesisë Bazë të Shkencave Kompjuterike. Vlerësimi i provimit bëhet nga një komision i posaçëm përbërja e të cilët është nga lektorë të Njesisë Bazë të Shkencave Kompjuterike dhe të miratuar dhe aprovuar nga Koordinatori i programit të studimit dhe nga Dekanati i FIT. Komisioni përbëhet jo më pak se 3 anëtarë. GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i provimit bëhet mbi bazën e vlerësimit të miratuar nga Senati Akademik [DVV evidencë nr. 7 – Rregullore e programit të studimit, evidencë nr. 6 – Rregullore e FIT]</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>FIT në fillim të çdo viti akademik organizon edhe Javën e Orientimit. Në këtë javë studentët kanë mundësi të njihen me përmbajtjen e programit të studimit dhe detyrimet përkatëse të tyre. Kjo paraqitet edhe në Formularin e Aplikimit të përmirësuar cdo vit nga njësia baze e shkencave kompjuterike. Takime zhvillohen edhe me studentë të vitit të tretë në nivelin Bachelor. GVJ konstatoi se edhe sensibilizimi përmes përdorimit të rrjeteve sociale si facebook, instagram dhe website të UAMD-së janë disa forma përmes të cilëve studenti është njohur me programin e studimit dhe avantazhet në lidhje me punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve. Në këtë drejtim një rol të veçantë luan edhe Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni. [DVV – evidencë takim me studentët], [DVV – evidencë – takim me drejtues të zyrës së Komunikimit, Karrierës & Alumni].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e saj. Ata janë në dijeni për detyrimet në lidhje me lëndët formuese sipas nivelit Bachelor të diplomës që ata zotërojnë. Kjo është përcaktuar qartë edhe në kriteret e pranimit në Rregulloren e programit të studimit Kurrikula e programit të studimit është e pasqyruar edhe në website www.uamd.edu.al. Në fillim të vitit akademik dhe në fillim të çdo lënde bëhet nga Koordinator i Programit i cili është edhe drejtuesi i Njesisë Bazë të Shkencave Kompjuterike prezantimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Në fillim të çdo lënde nga lektorët bëhet një paraqitje e kurrikulës. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar në lidhje me përmbajtjen dhe strukturën e lëndës nga pedagogët e tyre. UAMD në lidhje me programet e studimit ka në dispozicion edhe broshura, fletpalosje dhe udhëzues. Në lidhje me këtë program studimi GVJ konstatoi dosjen e aplikimit si evidencë e cila në çdo vit përmirësohet dhe jep një informacion të qartë për programin e studimit, dhe mundësitë për punësim në mbarim të studimeve. Udhëzues të posaçëm dhe kurrikula e çdo lënde është disponibël tek studentët në fillim të çdo semestri dhe në fillim të çdo moduli që trajtohet. [DVV evidencë 7- Rregullore e Programit të studimit, evidencë nr.11 – Dosja e plotë e aplikimit]. [DVV evidencë-takimi me studentët].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Njësia Baze e Shkencave Kompjuterike përmes planit strategjik 2019 – 2022 zhvillon një punë të madhe në drejtim të punësimit të studentëve në mbarim të studimeve të tyre. Punësimi i studentëve realizohet nga njohjet dhe kontaktet e vetë stafit akademik, nga bashkëpunimi me kompanitë e biznesit. Në këtë drejtim rol luan edhe Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni. Orientimi drejt tregut të punës realizohet edhe përmes studimit të tregut të punës pas diplomimit. [DVV evidencë nr. 23 – të dhëna për punësimin të studentëve, evidencë nr. 14 -Studimi i tregut pas diplomimit].</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Për komunikim të brendshëm është ndertuar sistemi AULA. Tashmë ky sistem mundëson një shpërndarje informacioni dhe komunikimi me studentët në nivelin Bachelor. Nga takimi me shefen e departamentit të Shkencave Kompjuterike theksua që shumë shpejt ky sistem do të jetë në funksionim edhe për studentet e nivelit Master Shkencor dhe Profesional. Në FTI është ngritur edhe sektori i Teknologjisë së Informacionit i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe vënien në funksion të sistemit AULA, si edhe shpërndarjen e informacionit tek studentët. Udhëzues dhe rregulloret shpërndahen në hallkat përgjegjëse dhe publikohen në website. Koordinator i programit në bashkëpunim edhe me stafin akademik komunikojnë edhe drejtperdrejtë udhëzimet e brendshme që kanë lidhje me përgjegjësitë, informimin dhe detyrimet për studentët. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni përdor forma të larmishme në lidhje me shpërndarjen e informacionit tek studentët. GVJ konstatoi se të gjithë hallkat pjesë përbërëse e tij luajnë një rol në këtë drejtim. Takimi me studentët tregoi një informim të qartë të tyre në lidhje me programin,</p>

informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	<p>përmbajtjen e tij, detyrimet dhe përgjegjësite përkatëse të studentëve dhe stafit akademik. Ndër hallkat më të rëndësishme vlen të përmenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shperndarja e informacionit [udhezime nga Rektorati, Dekanati dhe nga MASH] nga koordinatori i programit përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe në bashkepunim me stafin akademik. 2. Informacion në lidhje me kurrikulën dhe detyrimet përkatëse të studentëve jepet nga stafi akademik; 3. Informacion në lidhje me regjistrimin, numrin e matrikulës së studentit, vlerësimet në provime, oraret, pagesat merren nga sekretaria mësimore; 4. Informacion në lidhje me punësimin merret nga stafi akademik dhe Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni; 5. Informacioni shpërndahet edhe në forme on-line përmes ëbsite www.uamd.edu.al, përmes fabebook, instagram, etj. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna periodike dhe vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar, të diplomuar. Këto të dhëna mbahen nga Njesia Baze e Shkencave Kompjuterike dhe nga Sekretaria Mësimore e cila në bazë të rregullores së brendshme të saj dhe bazuar edhe në udhëzimet e MASH përdor rregjistrat të veçantë për regjistrimin e studentëve me një numër të veçantë përkatës matrikulimi, realizon hedhjen e notave në rregjistrin e notave dhe përdor rregjistrin për studentët e diplomuar. Nga vizita në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi një dokumentacion të rregullt në lidhje me të dhënat e studentëve, rregjistrat përkatës dhe dosjet personale të secilit student. Në lidhje me studentët e diplomuar mbahet një rregjister i veçantë. Diploma dhe tërheqja e saj bëhet nga studentët ose me prokurë të posaçme nga një person i autorizuar. Nga të dhënat e gjetura në këtë zyrë konstatojmë si vijon më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="766 1758 1220 1937"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>67</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>31</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Statuti - neni 76], [DVV dok. shtese]</p>	Viti akademik	Të diplomuar	2016-2017	67	2017-2018	31	2018-2019	12	2019-2020	në proces
Viti akademik	Të diplomuar										
2016-2017	67										
2017-2018	31										
2018-2019	12										
2019-2020	në proces										
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave të studentëve. Këto të dhëna mbahen në format hardcopy në rregjistrin</p>										

studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

themeltar, rregjistrin e notave dhe në fund të vitit u transmetohet Njësisë Baze të Shkencave Kompjuterike e cila bën përpunimin e tyre në formë të analizave statistikore dhe pasqyrimin në raportet vjetore.

Nga të dhenat e gjetura në këtë zyre [DVV dok. shtese] konstatohet si vijon më poshtë:

Viti akademik	Të regjistruar	Të ç'regjistruar	Të transferuar
2016-2017	87	2	0
2017-2018	44	4	0
2018-2019	34	0	0
2019-2020	33	0	0

Nga vizita në Sekretarinë Mësimore konstatohet si vijon më poshtë:

- -Në kontrollin e rregjistrin themeltar regjistrimet janë shumë korrekte me përjashtim të vitit 2017 ku evidentuam vetëm një rast pa numër matriculimi;
- Për vitin 2018-2019 evidentuam 12 raste pa numër matriculimi e cila vjen si shkak i plotesimit të dokumentacionit nga QSHA dhe vonesës në pergjigje nga ana e tyre, ose disa student figurojnë në 2 programe master njëkohësisht dhe kërkohet ç' regjistrimi i tyre.

GVJ kontatoi një rënie të numrit të studentëve të regjistruar për vitin 2019 – 2020. Kjo rënie e studentëve ka të bëjë me ndikimin që ka dhënë hapja e dy programeve të reja (Master Profesional) përkatësisht:

- Sistemi i planifikimit të ndërmarrjeve
- Multimedia dhe sistemi digital
- Matematike Informaike (Master për mësuesi)

Nga ana tjetër na u theksua që për keto dy vitet e fundit ka një rritje të numrit të studentëve në nivelin Bachelor e cila do të reflektohet në vitet e ardhshme në regjistrimet për Master Profesional.

[DVV evidence: dok shtese]

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Strukturat përkatëse të ngritura në UAMD menaxhojnë të dhënat e studentëve, kushtet e pranimit të tyre, progresin dhe diplomimit të tyre. Në strategjinë e zhvillimit 2019-2022 një fokus të veçantë ka diplomimi i studentëve brenda afateve të caktuara. Të dhënat ruhen dhe administrohen në hardcopy, excel dhe në sistemin AULA. Të dhënat përpunohen në formë të raporteve periodike nga struktura të posaçme sic është raportet vjetore të njësisë baze të inxhinierisë kompjuterike, NJSBC, zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni etj.

GVJ konstatoi mirë-administrim të të dhënave të studentëve, dosjeve personale të tyre. Të dhënat ruhen mbi bazën e rregulloreve të brendshme të miratuara dhe aprovuara nga Dekanati i FTI, Senati Akademik dhe ne perruthje me udhëzimet dhe direktivat në fuqi nga MASH. Të dhënat janë të aksesueshme nga hallkat dhe strukturat bazë dhe ndihmëse të UAMD pa çënuar konfidencialitetin e tyre.

Kriteri 5. Institucioni duhet të

GVJ konstatoi ngritjen e Zyres së Këshillimit, Karrierës & Alumni e cila

<p>hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>administron të dhënat vjetore në lidhje me notën mesatare në hyrje dhe në dalje të studentëve. Të dhënat për progresin e studentëve janë të reflektuar edhe në raportet vjetore të NJB Shkencave Kompjuterike.</p> <p>Programi I studimit ka në fokus të tij si qëllim kryesor punësimin e studentëve pas mbarimit të studimeve. Kjo është reflektuar edhe në strategjinë e zhvillimit 2019 – 2022. Për rritjen e numrit të studentëve të punësuar një punë serioze zhvillohet nga Zyra e Këshillimit, Karrierës & Alumni.</p> <p>Vërejmë se të dhënat e deklaruara nga zyra e Këshillimit, Karrierës & Alumni nuk përcaktojnë qartë impaktin e programit të studimit në drejtim të rritjes së punësimit. Në evidencën nr.23 kontatojmë të dhëna të statusit të studentit gjatë zhvillimit të programit të studimit. Në këto të dhëna konstatojmë se 12 studentë janë të punësuar, 7 të papunë dhe 2 pa një status të qartë. Nuk gjejmë të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve në fund të studimeve të tyre.</p> <p><u>Rekomandojmë që të dhënat nga kjo zyrë të japin me drejtë impaktin e programit në drejtim të punësimit të studentëve, punën e bërë në ndjekjen e studentëve që kanë status të papunë mbas mbarimit të studimeve të tyre.</u></p> <p>[DVV evidence nr.23]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstatoi një kuadër ligjor të qartë në lidhje me përfaqësimin e studentëve në vendimarrje. Kjo është e sanksionuar në Statut të UAMD-së ku studentet kanë të drejtë të përfaqësohen ne organet e UMAD me përjashtim te rasteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe kane te drejte te marrin pjese ne te gjithë proceset e vendimarrjes se UMAD-se ne perputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Nga takimi me studentet ne kete program studimi nuk GVJ konstatoi se nuk ka nje pjesemarrje ne forume dhe keshilla stundetore.</p> <p>[DVV evidence nr.2 – Statut UAMD, evidence – takimi me studentet]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të</p>	<p>Institucioni i jep te drejte studenteve te marrin pjese ne vleresimin e procesit mesimor, performances akademike te stafit akademik. Bazuar edhe ne kuadrin ligjor per zgjedhjet ne organet vendimarrrese, studnetet kane te drejten e votes ne kete process votimi.</p> <p>[DVV evidence nr.2 – Statut UAMD, evidence nr. 5 Rregullore IAL UAMD,; evidence takimet e zhvilluar ne institucion];</p>

verifikueshme e të matshme.									
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Stafi akademik angazhuar për këtë program studimi në vijueshmeri zhvillon punë në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së lendeve pjesë perberese e këtij program. Në drejtim të përmirësimit merret mendimi nga progresi i fushës së shkencave kompjuterike në ditët tona, eksperiencën e marrë nga pjesëmarrja në trajnime dhe konferenca ndërkombëtare, mendimi nga kompanitë e biznesit me të cilat janë lidhur marrëveshje institucionale dhe nga vete sugjerimet e studentëve në komunikimin e drejtperdrejtë ose nga pyetsoret e plotësuar.</p> <p>Ky përmirësim lehtëson ngarkesën teorike të studentëve dhe ka prioritet në zhvillimin me të madh të praktikës gjatë orëve laboratorike duke mundur një aftësim me profesional të tyre.</p> <p>[Evidenca Nr. 6 - Rregullore e FTI, Neni 61, pika 1. 3]</p>								
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p>Institucioni në fund të çdo semestri organizon sondazhe me studentët për të matur opinionin e tyre në lidhje me zhvillimin e programit të studimit. Studentët janë pjesë aktive në këtë drejtim. Sugjerimet, vërejtjet e paraqitura reflektohen në Departamentin e Shkencave Kompjuterike në drejtim të përmirësimit të asaj që është evidentuar problematike.</p> <p>[DVV evidence takimi me NJSBC, takim me studentët]</p>								
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>GVJ konstatoi se institucioni i garanton studentit të shprehë mendimin, të marrë pjesë aktive në vlerësimin e procesit. Bazuar në aktet ligjore të shprehur në dokumentat baze të institucionit studentët kanë të drejtën e vlerësimit të kontrollit të dijeve të bera nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mireinformuar në këtë drejtim, ndonëse ankimet ishin sporadike.</p> <p>[DVV evidence nr. 2 –Statut UAMD, evidence nr.5 – Rregullore e UAMD, evidence nr. 6 – Rregullore e FIT, evidence nr. 7 – Rregullore e Programit të studimit, takim me studentët, takim me stafin akademik]</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

UAMD ka krijuar në vitin akademik 2018-2019 Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe është ristruktuar në shkurt të vitit 2019. Në fokus të punës së saj kjo zyre ofron këshillime, orientim karriere dhe seminare për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës. Ngritja e kesaj struktura dhe funksioni i saj bëhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore në fuqi. [DVV evidence- Raporti periodik vjetor 2018-

	2019]
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit..</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni është nën juridiksion të Drejtorisë së Administrimit & Sherbimeve Akademike. Kjo zyre zhvillon punën e saj në drejtimet e mëposhtme:</p> <p>a. <i>Asistencë studentëve në lidhje me procesin mësimor. Kjo zyre shërben për komunikimin e studentëve në lidhje me problematikat që ndeshen gjatë procesit mësimor dhe zgjidhjen e tyre përmes bashkëpunimit me hallkat përkatëse dhe njesinë baze të inxhinierisë kompjuterike;</i></p> <p>b. <i>Asistencë të studentëve në drejtim të kerkimit shkencor. Në këtë drejtim kjo zyre zhvillon punë në lidhje me informimin e studentëve për konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre;</i></p> <p>c. <i>Këshillim në lidhje me karrierën. Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni zhvillon punë në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale me kompanitë e biznesit, organizimin e panairit të karrieres dhe trajnimet të studentëve si të hartojnë CV dhe mënyrën e përgjigjes në intervista të ndryshme;</i></p> <p>Megjithatë punën serioze të kryer nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga takimi me studentet GVJ konstaton se Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni nuk është shumë aktive në punën e saj me studentet e programit MPSHKA.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni zhvillon punë me studentet në drejtim të punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve. Në këtë drejtim në fokus të punës së saj është lehtësimi i rrugetimit të studentëve në punësim përmes ofrimit të këshillimit, informimit për oferta punësimit dhe këshillimit mbi përgatitjen e CV dhe pyetjeve në intervista. Kjo zyre shërben edhe si urë lidhje midis kompanive të biznesit dhe studentëve e cila realizohet përmes organizimit të Panairit të Karrieres.</p> <p>Punë sensibilizuese bëhet me studentet e diplomuar. Në sesionin “Alumni talks” e cila shfaqet në rrjetet sociale jepet përvoja e studentëve të diplomuar. Organizohen edhe sesione të vecanta me të ftuar të nderit. Sesioni i vecantë këtë vit u bë në 13 Dhjetor dhe i ftuar ishte z. R Sh – sipërmarrës nga IT.</p> <p>[DVV evidence – Rregullore e Këshillimit, Karrieres & Alumni, takim me përfaqësues të zyrës së Karrieres & Alumni, dok. shtese - Kalendar i aktiviteteve 2019-2020 të Zyres së Karrieres]</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Te dhënat në lidhje me studentet mbahen në një database të vecantë. Te dhënat e përpunuara japën në formë raporti në fund të vitit. Duke konsideruar që zyra e Komunikimit, Karrieres & Alumni është ristrukturuar në Shkurt 2019, nuk kemi një raport vjetor të dorëzuar nga kjo zyre.</p> <p>[DVV evidence – Rregullore e Këshillimit, Karrieres & Alumni, takim me përfaqësues të zyrës së Karrieres & Alumni, dok. shtese - Kalendar i aktiviteteve 2019-2020 të Zyres së Karrieres]</p>
Shkalla e përbushjes së	Nuk përbushet Përbushet Përbushet Përbushet

standardit		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UAMD harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të insitucionit. Politikat e hartuara në këtë drejtim janë të bazuar në aktet ligjore në fuqi. Ndër më kryesoret përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 103,104, 106 dhe 46; • Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM Nr.531, datë 11.9.2018 ; • Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SUE) ; • Statutin e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ; • Rregulloren e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ; • Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë; <p>UAMD ka ngritur me vendim Senati Akademik struktura përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Këto struktura ndahen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Struktura ne nivel institucional dhe perfshijne: <ol style="list-style-type: none"> a. Senati Akademik; b. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë (KPGSC); c. Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë (DKSC)/ Koordinatori institucional pranë ASCAL; d. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC); 2. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Stnadarteve të

	<p>Cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjSBC Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit për programin e studimit MPSHKA); Grupi i vleresimit të brendshëm për çdo program (GVB MP për këtë program studimi); Koordinatorët e Programeve (Ko.MP e cila për këtë program është edhe drejtuese e Njesisë Bazë të Shkencave Kompjuterike); <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave në nivel insitucional jepen në Statut përkatësisht neni 77, 78, 79, 80 dhe 81, ndërsa detyrat e strukturave në nivel fakulteti janë të përcaktuar qartë në Rregulloren e Brendshme të NjSBC. [DVV evidencë nr.2 – neni 77/Statut I UAMD], [DVV. Evidencë nr. 119 – Rregullore e NjSBC]. [DVV evidencë nr.119 – Rregullore e SBC].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD ka ngritur një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë që funksion në të gjithë hallkat e tij. Veprimtaria e tij është e lidhur ngushtë me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit. Në lidhje me programin e studimit MPSHKA, GVJ konstaton që synimet strategjike nr.2 dhe nr.3 me objektivat si vijnë më poshtë kanë një lidhje të ngushtë për sigurimin e cilësisë në procesin mësimor, infrastrukture dhe mjete.</p> <ul style="list-style-type: none"> objektivi 2-b “<i>Të zhvillojmë e të përmirësojmë personelin, pajisjet dhe teknologjitë e duhura për të lehtësuar arritjen e studentëve në majat e suksesit</i>”, objektivi 2-c “<i>Të ofrohen metodika studimi dhe praktika profesionale që ndihmojnë në marrjen e dijeve të nevojshme për të përfunduar në kohë programin e studimit</i>” objektivi 3-b “<i>Të sigurohet akreditim i vazhdueshëm për programin e studimit</i>”. <p>Në lidhje me zbatimin e ketyre objektivave strategjike strukturat përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë bashkëpunojnë me të gjithë strukturat akademike, studentë dhe bashkëpunëtor të jashtëm (si kompanite e biznesit) për të siguruar një cilësi të lartë në procesin mësimor. [DVV evidencë nr.4 – Plani Strategjike 2019-2022].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD i përmbahet standarteve evropiane kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Standardi 1: Politika për sigurimin e cilësisë</i> - <i>Standardi 2: Hartimi dhe miratimi i programeve</i> - <i>Standardi 3: Të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin</i> - <i>Standardi 4: Pranimi i studenteve, progresi, njohja e krediteve</i>

	<p><i>dhe diplomimi i tyre</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Standardi 5: Personeli akademik</i> - <i>Standardi 6: Burimet e të nxëniet dhe mbështetja për studentin</i> - <i>Standardi 7: Menaxhimi i informacionit</i> - <i>Standardi 8: Informimi i publikut</i> - <i>Standardi 9: Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve</i> - <i>Standardi 10: Sigurimi i jashtëm ciklik i cilësisë</i> <p>Në lidhje me standartin e fundit UMAD i nënshrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike (1 herë në 6 vjet) në erëputhje me standartet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p> <p>Sigurimi cilësisë është i bazuar mbi vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të UAMD, cilësisë së programit të studimit, cilësisë së studentëve, cilësisë së punës së stafit akademik dhe cilësisë në drejtim të kërkimit shkencor. [DVV evidencë nr.4 – Plani Straegjike 2019-2022, evidence nr. 2 Statut UAMD, evidence nr.119 Rregullore e NJSBC].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>UAMD ka ngritur një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksion në të gjithë nivelet e institucionit. Veprimtaria e tij është e bazuar në politikat dhe Strategjine Institucionale të UAMD. Në synim të kësaj veprimtaria është sigurimi i cilësisë së programeve të studimit si pjesë përbërëse e veprimtarisë mësimore të vetë institucionit [DVV evidencë nr.4 – Plani Straegjike 2019-2022, evidence nr. 2 Statut UAMD, evidence nr.119 Rregullore e NJSBC].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton për këtë program studimi angazhimin e strukturave si vijon më poshtë në sigurimin e cilesisë:</p> <p>Ne nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NJSBC Fakulteti i Teknologjise se Informacionit për programin e studimit MPSHKA); b. Grupi i vlerësimit të brendshëm për çdo program (GVB MP për këtë program studimi);

	<p>Koordinatorët e Programeve (Ko.MP e cila për këtë program është edhe drejtuese e Njësisë Baze të Shkencave Kompjuterike)</p> <p>Kjo strukturë angazhohet drejtpërdrejtë në monitorimin, matjen e cilësisë dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UAMD përdor mekanizma dhe procese për shqyrtimin dhe monitorimin e programit të studimit. Kjo realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) përcaktimit të kritereve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar ne modelet e brëndshme te UAMD; b) standardeve dhe kritereve të cilësisë së programit të studimit sic përcaktohen ne kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë; c) rregullores së studimit për këtë program studimi; d) cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin; e) politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore; f) infrastrukturës mësimore; g) ndërkombëtarizimit të programeve; h) monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>UAMD ka të institucionalizuar Sistemin e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në Statutin dhe në Strategjine e Zhvillimit të tij. Përfaqësimi i këtij sistemi buron që nga niveli i vendimarrjes që është Senati Akademik deri në nivel Njese baze dhe përkatësisht për programin e studimit MPSHKA.</p> <p>Si metodologji vlerësimi përdoren pyetësorët dhe sondazhet të cilët kanë në synimin e tyre përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësimin e stafit akademik dhe cilësisë së shërbimeve të UAMD-së.</p> <p><u>Vlerësimi i procesit mësimor realizohet përmes:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a) Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat. Ky pyetësor eshte propozuar nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik; <p><u>Vlerësimi nga ana e drejtuesit të Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike për stafin akademik që ai drejton realizohet përmes:</u></p>

	<p>a) Pyetsorit i cili zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD) sigurohet nëpërmjet:</p> <p>a) Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin;</p> <p>b) Pyetësorit të stafit akademik, i cili vlerëson institucionin;</p> <p>c) Pyetësorit të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin;</p> <p>Cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucioni për studentët matet kryesisht nga hartimi dhe zbatimi i politikave për shërbimet inovative në universitet, infrastrukturës, faciliteteve, bibliotekës, shërbimeve nga ana e sekretarive mësimore, teknologjisë së informacionit etj.</p> <p>Ky vlerësim realizohet një herë në vit, zakonisht brenda muajit Qershor të çdo viti akademik.</p> <p>Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave realizohet nga DKSC e cila ja paraqet rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme.</p> <p>Edhe në këtë rast, formati i pyetësorëve propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve të mbledhur përpunohen dhe paraqiten në raporte vjetore. Për programin e studimit MPShKA nuk gjejmë evidencë në lidhje me përpunimin statistikor të pyetësorëve dhe pasqyrimin e tyre në raportin vjetor. GVJ evidenton që ka një komunikim aktiv të strukturave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me Njësine Bazë të Shkencave Kompjuterike por nuk kemi njohur me produktet /raportet periodike apo vjetore. Në dokumentacion është paraqitur Raporti i Vlerësimit të Pyetësorit i cili i përket periudhës 2017 – 2018 dhe paraqet rezultatet për programin Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Gjithashtu është paraqitur edhe formati i pyetësorit të studentit por është thjesht për një pedagog dhe aspak për të gjithë stafin akademik me kohë të plote apo të pjesshme të përfshirë në këtë program studimi. GVJ u njoh edhe dok. Nr. 32 – Anketimi i studentëve dhe lektorëve por në këtë dokument paraqiten të dhëna të përpunuara në nivel universiteti dhe nuk specifikohen qartë programet e studimit. Në këtë mënyrë GVJ e ka të vështirë të nxjerrë konkluzion në lidhje me problematikat e paraqitura nga pyetësori për programin në shqyrtim të studimit.</p> <p><u>Rekomandojmë që Strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të fokusohen më gjerësisht në programet e studimit Master. Ndonëse takimi me studentët konfirmoi që shpërndarja e pyetësorëve bëhet në mënyrë të rregullt periodike, mungesa e përpunimit të të dhënave dhe shprehja e tyre në trajte raporti</u></p>

	periodik e shoqëruar në problematikat e gjetura cënon rëndë cilësinë e procesit mësimor. [DVV dok.50 shtesë- Raport mbi vlerësimin e pyetsorit], [Dok. Shtesë – Pyesor i studenteve, format, shembull pyetsori, shembull raport vlerësimi].			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Mungesa e raporteve vjetore e bën të vështirë punën e GVJ në përcaktim e rezultatet e pritshme dhe masat për adresimin e mangësive. [DVV dok.50 shtesë- Raport mbi vlerësimin e pyetsorit], [Dok. Shtesë – Pyesor i studenteve, format, shembull pyetsori, shembull raport vlerësimi].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Vlerësimi i programit të studimit MPSHKA kryhet nga NJBC e Fakultetit të Teknologjise dhe Informacionit. Kjo strukturë ka në anëtarësi Z/Dekananin për Arsimin dhe Shkencën, 3 pedagogë PAE dhe 1 student si përfaqësi (kryesisht nga programi Master). Anëtarësia e saj ka ardhur si reflektim i kërkesave për këtë strukturë nga MASH në vitin 2018. Përzgjedhja e anëtarësisë bëhet me miratimin e Dekanit të FTI dhe aprovimin nga Dekanati. Kjo strukturë është përgjegjëse për shpërndarjen e pyetsoreve tëk studentët zakonisht në javën e 13 ose 14 (ne fund të çdo semestri) për çdo lëndë. NJSBC e Fakultetit të FTI në bashkëpunim edhe me kordinatorin e programit të studimit ndërmerr edhe shpërndarjen e pyetsorit për vlerësimin e stafit akademik. Ky pyetsor bëhet online dhe realizohet një herë në vit (kryesisht në fund të vitit akademik). Në kuadër të vlerësimit të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga UAMD, NJSBC bashkëpunon me Departamentin e Shkencave Kompjuterike për të shpërndarë edhe pyetsorin për infrastrukturën. Ky pyetsor zhvillohet në fillim të vitit akademik.</p> <p>Pyetsorët i nënshtrohen procesit të skanimit dhe AADF është përgjegjëse për numurimin e tyre dhe përpunimin e rezultateve. Rezultatet e përfuara i transmetohen në mënyrë konfidenciale dhe individuale stafit akademik dhe pasqyrohen edhe në raportet vjetore përkatësisht të Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë. Një pjesë e të dhënave shërben edhe në hartimin e RVB në kuadër të akreditimit intitucional dhe në veçanti të programit të studimit. [DVV evidencë nr.31-Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit; takim me përfaqësues të NJSBC]</p>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit,	GVJ konstatoi veprimtarinë e NJSBC në FTI në drejtim të vlerësimit

<p>institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>të programit të studimit dhe në drejtim të kërkimit shkencor. Në thelb të veprimtarisë së saj qëndron analiza e procesit mësimor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. Për realizimin e procesit të vlerësimit NJSBC përdor metoda të matjes së drejtpërdrejtë dhe kontrollit periodik të procesit mësimor.</p> <p>[DVV-evidence shtese - Pyetesori i studenteve, format, shembull pyetesori, shembull raporti vleresimi.]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NJSBC është përgjegjëse për implementimin e anketimeve tek studentët në lidhje me matjen e performancës dhe cilësisë së programit të studimit. Këto anketime kryhen dy herë në vit (ne fund të çdo semestri). Përpunimi i të dhënave bëhet përmes programeve dhe finalizohen në një raport përfundimtar. Rezultatet e anketimeve paraqiten tek stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit. Një raport përfundimtar paraqitet edhe në Senat i cili ndërmerr edhe përmirësimet e duhura në bazë të problematikës dhe rekomandimeve përkatëse të paqyruara në raport.</p> <p>Vleresimi nga pyetsorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i kurrikulës së programit të studimit nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë. Ky rishikim iniciohet nga rezultatet e pyetsorëve dhe në përmirësimin e saj bazohet në konsiderimin e kurrikulave të ngjashme dhe të suksesshme si edhe në marrjen e përvojës më të mirë. Në këtë drejtim një punë e madhe bëhet në përkthimin e tyre dhe marrja e një feedback nga ana e Departamentit të Shkencave Kompjuterike - Pyetsori i vlerësimit nga stafi akademik ; - Pyetsori i vlerësimit të infrastrukturës; <p>Vlerësimi përmes zbatimit të metoda së drejtpërdrejte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëbashkëpunim me koordinatorin e programit bëhet vlerësimi i pjesëmarrjes së studentit në orët e mësimi; • Vlerësimi i detyrave të realizuara nga studenti; <p>[DVV shënimet nga takimi me NJSBC]; [DVV evidencë nr.32-Pyetsori i studentëve; evidence shtese-Pyetesori i studenteve, format, shembull pyetesori, shembull raporti vleresimi.]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim edhe me NJSBC e FTI ndërmerr metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit. Vlen të përmendet :</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetsori i studentëve (i cili përmban 66 pyetje); • pyetsori i stafit akademik (i cili përmban 85 pyetje); • Pyetsori për stafin administrative (i cili konsiston në 16 pyetje); <p>Ndër metoda të tjera vlen të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i vlerësimit me nota/pikë (në proceverbalet e

<p>vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>plotësuar për çdo lëndë nga stafi akademik);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i testimeve të pjesshme dhe përfundimtare; • Kontrolli i procesit të mësimdhënies; • Kontrolli në lidhje me shfrytëzimin e infrastrukturës (kryesisht klasat, laboratorët dhe mjetet didaktike) • Kontrolli i detyrave/projekteve të kursit; <p>Koordinatori i programit në bashkëpunim edhe me stafin akademik merr edhe opinionet e studentëve alumni si edhe nga kompanitë e biznesit me të cilët bashkëpunon (kryesisht në këtë drejtim një rol pozitiv ka dhënë kompania CISKO e cila ka investuar edhe në laboratorë) [DVV evidencë nr.32, takimi me studentët, takimi me NJSBC evidence shtese-Pyetesori i studenteve, format, shembull pyetesori, shembull raporti vleresimi.];</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD garanton krijimin e një strukture të vlerësimit të brendshëm të cilësisë e cila është gjithëpërfshirëse. GVJ konstaton veprimtarinë saj të zhvillohet në nivel program studimi, departamenti, fakulteti dhe në nivel institucion dhe vendimarrës. Në veprimtarinë e saj ajo bashkëpunon me koordinatoren e programit të studimit, përgjegjësin e Njësisë Bazë të Shkencave Kompjuterike, Dekanatin e FTI. Anëtarësia e NJSBC në FTI është shprehje e angazhimit të stafit akademik dhe studentëve në këtë process vlerësimi për të garantuar edhe transparencën në këtë veprimtari [DVV evidencë nr. 119 – Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, evidencë nr. 2 Statut i UAMD, neni 80, pika 2];</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë i ngritur në UAMD funksionon mbi bazën e një set rregulloresh dhe ndarjeve të roleve dhe përgjegjësi. GVJ konstatoi nga shqyrtimi i materialeve dokumenta mbi bazën e të cilave janë në funksion strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe Fakulteti përgjegjese për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë. [DVV evidencë nr.2 Statuti UAMD, neni 80, evidencë 5- Rregullore e IAL UAMD, evidencë nr.6 - Rregullore e FTI, evidencë nr. 7 – Rregullore e Programit të Studimit; evidencë nr. 119– Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë].</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore,</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit MPSHKA është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. GVJ konstatoi një pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve, koordinorit të programit të studimit, dekanatit të FTI në këtë proces. Në lidhje me</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit evidentojmë një bashkëpunim të stafit akademik, kompanive të biznesit me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) [DVV Takim me NJSBC, takim me studentët; takimi me kordinatorin e programit të studimit; takimi me dekanen e FTI;]</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Vënia në funksion e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës. Në këtë proces ruatja e integritetit dhe konfidencialitetit janë evidente dhe konsiderohen të rëndësishme. Rezultatet e pyetsorëve të stafit akademik shpërndahen individualisht duke ruajtur konfidencialitetin e tyre. Ky proces karakterizohet edhe nga transparenca në shpërndarjen e duhur të informacionit dhe në vendimarrjen e marrë nga Senati Akademik lidhur me rekomandimet e shprehura nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC);</p> <p>NJSBC në FTI ka përfshirë në procesin e vlerësimit të saj edhe pedagogët e jashtëm. Një pyetsor i veçantë është plotësuar nga studentët në lidhje me stafin akademik PAK (për vitin 2019 – 2020 në këtë program studimi nuk janë angazhuar staf akademik i jashtëm).</p> <p>[DVV evidencë nr.2 Statuti UAMD, neni 80, evidencë 5- Rregullore e IAL UAMD, evidencë nr.6 -Rregullore e FTI, evidencë nr. 7 – Rregullore e Programit të Studimit; evidencë nr. 119– Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e</p>	<p>GVJ konstaton transparencë të procesit të vlerësimit të cilësisë në programin e studimit. Shpërndarja e pyetsorëve, përpunimi i tyre dhe rezultatet e sondazheve komunikohen në të gjithë hallkat pjesë përbërëse e këtij procesi. Rezultatet e pyetsorëve shpërndahen në mënyrë individuale tek i gjithë stafi akademik i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në programin e studimit. Të dhënat nga matjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndërmarra nga NJSBC në bashkëpunim me kordinatorin e programit reflektohen qartë në raportet vjetore. Vendimet kryesore të lidhura drejtpërdrejtë me këtë proces shpërndahen përmes postës elektronike tek studentët dhe stafi akademik. GVJ konstaton një transparencë në lidhje me publikimin e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit. Përpunimi i të dhënave nga AADF i komunikohet kordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për vënien në dispozicion individualisht tek i gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi duke respektuar etikën dhe lirinë akademike GVJ konstaton se ka një mungesë evidencash nga ana e Departamentit të Shkencave Kompjuterike në lidhje me marrjen e një plan masash që synojnë në</p>

dobësive të evidentuara.	përmirësimin e problematikës së evidentuar. Raporti vjetor i paraqitur në evidencën nr. 31 nuk përfshin problematikën e paraqitur nga rezultatet e vlerësimit dhe nuk shoqërohet edhe me rekomandimet përkatëse për përmirësim. [DVV evidencë nr.31 – Analiza vjetore e departamentit] [DVV evidence-Takim me NJSBC].			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e IAL UAMD në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucioni i jep këtij procesi. Strukturat drejtuese të UAMD përmes asamblesë akademike të institucionit organizojnë takime periodike me studentët dhe stafin akademik për të informuar në lidhje me vendimarrjet kryesore. Çdo fillim/ fund viti akademik bëhet edhe mbledhja e Asamblese me Rektoren ku paraqitet edhe raporti vjetor dhe rekomandimet përkatëse për përmirësim [DVV evidencë nr. 48]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara” të “Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’, Durrës”

Pikat e forta dhe Afirmime

1. FTI dhe Departamenti i Sshkencave Kompjuterike organizon këtë program studimi përmes angazhimit të një stafi akademik profesional dhe të kualifikuar;
2. Zhvillimi i Shkencave Kompjuterike e bën këtë program të kërkuar në tregun e punës;
3. Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara” plotëson nevojat e nivelit rajonal të Durrësit;
4. Infrastruktura, laboratorët janë sipas standardeve të kërkuara për të garantuar cilësinë në mësimdhënie;
5. Ka një komunikim interaktiv pedagog-student
6. Zhvillimi i procesit mësimor gjatë fundjavës e bën tërheqës për studentët, të cilët janë të punësuar;

Pika të dobta

1. Cilësia e dobët e studentëve në hyrje të këtij programi studimi.

2. Numër minimal i stafit akademik me grada shkencore në fushën e Shkencave Kompjuterike në Departamentin që ofron këtë program studimi.
3. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe për këtë program studimi.

Pikat e dobta të dhëna më sipër, **sipas GVB**, janë të drejta, për sa kohë institucioni ka synime më të larta se kërkesat minimale ligjore. Por mendojmë se duhen shtuar edhe:

4. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk ka raporte në lidhje me përpunimim statistikor të pyetsorëve për këtë program studimi;
5. Zyra e Këshillimit Karrierës & Alumni si Sektor i ristruktuar është akoma e dobët në funksionimin e saj;
6. Ka një numër të vogël të bashkëpunimeve institucionale me kompanitë e biznesit në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale për këtë program studimi;

Rekomandime

GVJ rekomandon që:

1. Strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të fokusohen më gjerësisht në programet e studimit Master. Ndonëse takimi me studentët konfirmoi që shpërndarja e pyetsorëve bëhet në mënyre të rregullt periodike, GVJ konstaton mungesë të përpunimit të dhënave dhe shprehjen e tyre në trajtë raporti periodik.
2. Të dhënat nga Zyra e Këshillimit, Karrierës & Alumni duhet të japin më drejtë impaktin e programit në drejtim të punësimit të studentëve, punën e bërë në ndjekjen e studentëve që kanë status “të papunësuar”, mbas mbarimit të studimeve të tyre.
3. Zgjerimin e fushave të bashkëpunimit me kompanitë e biznesit në drejtim të praktikave profesionale të studentëve.
4. Përmirësimin e cilësisë në hyrje të studentëve të këtij programi studimi, pavarësisht faktit që aktet ligjore nuk kanë kërkesa specifike të mesatares në hyrje për programet Master profesional;
5. Të merren masa për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik të fushës së Shkencave Kompjuterike në Departamentin ku ofrohet programi i studimit, për të përballuar ndryshimet e vazhdueshme në fushën e shkencave kompjuterike.
6. Të hartohet një plan dhe të merren masa për pasurimin e bibliotekës me literaturë në gjuhën shqipe për këtë program studimi.
7. Të rishikohen syllabuset duke shtuar informacion për *Elementët e veprimtarisë mësimore* (leksion, seminar, laborator), si dhe për ndonjë pasaktësi të mundshme (p.sh tek elementi: Tipologjia e lëndës)

Conclusions of Evaluation of Second Level Study Programme respectively Professional Master in “Applied Computer Science” of the “Aleksander Moisiu” University, Durrës

Strong Points and Affirmations

1. The FTI and the Department of Computer Science organize this study program through the engagement of a professional and qualified academic staff;

2. Development of Computer Engineering Science makes this program attractive in the labor market;
3. Professional Master's Degree Program in "Applied Computer Science" meets the needs of the Durres regional level;
4. Infrastructure, laboratories are in compliance with the standards required to guarantee the quality of teaching;
5. There is an interactive teacher-student communication
6. The organizing of teaching process over the weekend makes it attractive for students who are currently employed;

Weak Points

1. Poor quality of students at the beginning of this study program.
2. Minimum number of academic staff with degrees in the Department of Computer Science engaged in this study program.
3. Lack of literature in Albanian language for this study program.

The weak points stated above from Self Evaluation Group are correct, as far as the Institution is aiming to reach higher goals than minimum legal requirements. The EEG think that should be added also the following points:

4. The Office of Internal Quality Assurance has no reports regarding the statistical processing of questionnaires for this study program;
5. The Career Counseling & Alumni Office as a restructured sector is still weak in its functioning;
6. Low number of Institutional Cooperation with business companies regarding the professional practice development for this study programme;

Recommendations

The EEG recommends:

1. The Internal Quality Assurance Structures should focus more on Master's degree programs. Although the meeting with the students confirmed that the questionnaires were distributed in a regular basis, the EEG noticed a lack of data processing and their reflection in the form of a periodic report.
2. The data from the Counseling, Career & Alumni Office should correctly reflect the impact of the program on student employment, the work done in pursuing students who are unemployed after completing their studies.
3. To expand the areas of cooperation with business companies towards professional student internships/practices.
4. To improve the entrance/enrollment quality of the students of this study program, despite the fact that the legal acts do not have specific entrance average requirements for Professional Master programs;

5. To take action for continuing education in the Computer Science area of the academic staff within the Department offering the study program to cope with the ongoing changes in the field of Computer Science.
6. To develop a plan and to take action to enrich the library with Albanian language literature for this study program.
7. Revise syllabuses by adding information about the elements of the teaching activity (lecture, seminar, laboratories), as well as any possible inaccuracies (eg element: Typology of the subject).

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Assoc.Dr. Ana Ktona

Dr. Alketa Grepcka